

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	“Për krijimin dhe funksionimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat në Republikën e Shqipërisë”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
FAZAE POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Rregullorja e BE 2022/2399 për “Krijimin e Mjedisit të Dritares së Vetme të Bashkimit Evropian për Doganat dhe ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 952/2013” (e cila tashmë është zëvendësuar nga Rregullorja e BE 2024/2514 e datës 3 Korrik 2024).
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” dhe Plan i Veprimit 2022–2026”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	26.01.2026 - 23.02.2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	10/04/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 03.03.2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MF - Nr.1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TËPERSONIT TË KONTAKTIT)	
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i> Problemi paraqitet kryesisht në mungesën e një kuadri të qartë dhe të unifikuar rregullator që të mundësojë bashkëpunimin efektiv ndërinstitucional dhe shkëmbimin e të dhënave në fushën doganore. Aktualisht, nuk ekziston një bazë ligjore specifike që të përcaktojë modelin, funksionimin dhe përgjegjësitë për një sistem të integruar ndërmjet autoriteteve	

doganore dhe institucioneve të tjera kompetente, çka sjell fragmentim të proceseve dhe mungesë standardizimi.

Në praktikë, procedurat e importit, eksportit dhe tranzitit zhvillohen përmes proceseve të shpërndara, me ndërveprim me shumë institucione që operojnë në sisteme të ndryshme dhe me kërkesa të ndryshme dokumentare. Kjo situatë çon në përsëritje të dokumentacionit, verifikime të dyfishta, kohë të zgjatur përpunimi dhe rritje të barrës administrative për të gjitha palët e përfshira.

Gjithashtu, mungesa e sistemeve të unifikuara dhe standardeve të përbashkëta teknike, së bashku me përdorimin e proceseve pjesërisht manuale, krijon vonesa, ul efikasitetin e koordinimit ndërinstitutional dhe rrit rrezikun për pasaktësi, interpretime subjektive dhe transparencë të kufizuar.

Këto problematika reflektohen drejtpërdrejt në funksionimin e autoriteteve publike, duke vështirësuar koordinimin dhe kontrollin, në aktivitetin e operatorëve ekonomikë, përmes rritjes së kostove dhe kohës së procedurave, si dhe tek qytetarët, përmes ndikimit në disponueshmërinë, cilësinë dhe çmimet e mallrave. Në të njëjtën kohë, mospërputhja me standardet ndërkombëtare dhe praktikrat e Bashkimit Evropian kufizon efikasitetin e sistemeve doganore dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë në tërësi.

Nisma e propozuar për një krijimin dhe funksionimin e një Dritare të Vetme Kombëtare për Doganat është një reformë e madhe për digjitalizimin dhe modernizimin e aplikimeve/kërkesave të paraqitura në dogana dhe në autoritetet e tjera të bashkëpunimit ndërkufitar, që ka për qëllim uljen e burokracive administrative dhe uljen e kostove të transaksioneve tregtare gjatë procedurave të import – eksportit apo regjimit transit të mallrave në Republikën e Shqipërisë.

Kjo nisëm përbën një progres të rëndësishëm për lehtësimin e transportit në vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe rrugën drejt antarësimit në Bashkimin Evropian. Angazhimi për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian ka një rëndësi të veçantë dhe do të ketë ndikim në përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *Acquis* në çdo sektor, jo vetëm në fushën e transportit dhe procedurave doganore. Përafrimi i plotë me *acquis* të Bashkimit Evropian është një detyrë kryesore për të gjitha institucionet dhe shkon shumë më tej sesa objektivi i kësaj nisme, që është përgatitja për krijimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat. Kjo do të thotë konkretisht se ndryshimet ligjore që do të kërkohen për ngritjen e një Dritare të Vetme Kombëtare Doganore duhet të jenë me qasje afatgjatë dhe të parashikojnë përafrimin me Bashkimin Evropian dhe respektimin e Marrëveshjes CEFTA.

Rritja e shpejtë e tregtisë ndërkombëtare dhe *e-commerce* ka rritur nevojën për bashkëpunim dhe koordinim më të mirë midis autoriteteve të përfshira në procesin e zhdoganimit të mallrave në vend. Procesi i digjitalizimit bën të mundur adresimin më efikas të kësaj situate, duke lidhur sistemet e autoriteteve doganore me të autoriteteve të tjera kompetente bashkërenduese dhe duke mundur shkëmbim të automatizuar të të dhënave mes tyre, me qëllim forcimin e bashkëpunimit në procedurat doganore dhe jo-doganore.

Në këtë kuptim, kuadri aktual rregullator është i pamjaftueshëm për të mbështetur ndërveprimin efektiv midis autoriteteve doganore dhe autoriteteve të tjera kompetente

bashkërenduese. Një proces i plotë, i koordinuar dhe efikas i zhdoganimit të mallrave kërkon një mjedis rregullator të thjeshtuar, që mbështet efektivitetin dhe funksionimin e duhur të tregut dhe siguron mbrojtjen e konsumatorit.

Aktualisht, proceset e importit dhe eksportit përballen me disa sfida që e bëjnë të domosdoshme ndërmarrjen e nismës për krijimin e Dritares së Vetme Kombëtare. Procedurat janë të fragmentuara dhe kërkojnë ndërveprim me shumë institucione, duke sjellë dorëzim të përsëritur të dokumentacionit, si dhe në disa raste vonesa për operatorët ekonomikë. Po ashtu, një pjesë e proceseve aktuale mbeten pjesërisht manuale, çka krijon hapësirë për pasiguri, transparencë të kufizuar dhe risk për ndërveprime subjektive. Mekanizmat ekzistues të kontrollit kufitar mbështeten në burime të shpërndara në kohë reale, duke e vështirësuar parandalimin e rreziqeve dhe menaxhimin efikas të flukseve tregtare. Këto sfida pengojnë modernizimin e doganave, ulin konkurrueshmërinë e tregut dhe krijojnë devijime nga praktikatat dhe standardet më të mira ndërkombëtare, duke e bërë të domosdoshme ngritjen e një platforme të integruar, transparente dhe dixhitale si Dritarja e Vetme Kombëtare.

Aktualisht, operatorët ekonomikë duhet të ndërveprojnë me një numër të madh institucionesh doganat, autoritetet fitosanitare, veterinare, mjedisore, inspektoriatet, agjencitë rregullatore, etj. Çdo institucion kërkon dokumente, deklarime dhe verifikime të veçanta, shpesh me formate të ndryshme. Kjo krijon proces të ndërlikuar dhe të shpërndarë, ku çdo hap varet nga një institucion i veçantë.

Për të arritur një mjedis plotësisht digjital dhe një proces efikas të zhdoganimit të mallrave për të gjitha palët e përfshira, është e nevojshme të vendosen rregulla të reja bashkëpunimi midis këtyre autoriteteve, në një mjedis të unifikuar si ai i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat. Ky mjedis duhet të përfshijë një grup shërbimesh elektronike plotësisht të integruara, për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin digjital ndërmjet autoriteteve doganore dhe autoriteteve kompetente partnere, si dhe për të thjeshtuar proceset e zhdoganimit të mallrave për operatorët ekonomikë. Kjo nismë duhet të çojë, në veçanti, drejt një mbrojtje më të mirë të qytetarëve dhe drejt reduktimit të barrës administrative për operatorët ekonomikë dhe autoritetet doganore.

Për të realizuar këtë nismë, nevojitet një bazë ligjore dhe rregullatore e harmonizuar me legjislacionin e BE në këtë drejtim, marrëveshjet e tregtisë së lirë, si dhe instrumentat udhëzues dhe rekomandimet.

Projektimi dhe instalimi i “Një Dritareje të Vetme Kombëtare” ka si qëllim për të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e tregtisë dhe transportit, të lehtësojnë procedurat doganore të importit, eksportit dhe tranzitit, me dokumenta të standartizuara në një pikë të vetme, sipas rregulloreve dhe standarteve ndërkombëtare dhe marrëveshjeve të tregtisë së lirë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat e synuara të nismës së propozuar janë si vijon:

1. **Lehtësimi i procedurave doganore të importit, eksportit dhe tranzitit**, me dokumenta të standartizuara në një pikë të vetme, duke eliminuar paraqitjen e të njëjtave dokumenta disa herë, në institucione të ndryshme.
2. **Reduktimi i hapësirave për korrupsion dhe për aktivitete të paligjshme** duke dixhitalizuar procedurat dhe duke eliminuar ndërhyrjet manuale në proceset doganore dhe ndërinstitutionale.
3. **Sigurimi i një administrimi të koordinuar, koherent dhe të standardizuar** të të gjitha procedurave në pikat e kalimit kufitar, duke përdorur shkëmbimin automatik të të dhënave për të përmirësuar kontrollin dhe vendimmarrjen, si dhe për të shmangur mbivendosjet dhe vonesat.
4. **Sigurimi i një lëvizjeje më të shpejtë të mallrave** përmes integritetit të të gjithë institucioneve në një platformë të vetme, duke reduktuar kohën e pritjes për kontrolle, verifikime dhe marrjen e vendimeve mbi bazën e të dhënave të përbashkëta.
5. **Rritja e transparencës** përmes vendosjes së mekanizma të qartë të gjurmimit, duke siguruar informacion mbi regjistrimin e kërkesës, kohën e regjistrimit dhe statusin e procedurës për të cilat subjektet kanë aplikuar.
6. **Sigurimi i një zhdoganimi më të shpejtë të mallrave** përmes automatizimit të procesit, reduktimit të dokumentacionit dhe eliminimit të veprimeve të panevojshme, duke mundësuar akses në informacion në kohë reale dhe kryerjen e procedurave në mënyrë më të shpejtë dhe të koordinuar.
7. **Përdorim më efikas dhe produktiv të burimeve**, përmes përdorimit të pajisjeve moderne, sistemeve informatike dhe flukseve të standardizuara rrit produktivitetin e administratës dhe ul kostot operative.
8. **Reduktimi i kostove**, për palët e përfshira në këtë proces, përmes përmbushjes elektronikisht të formaliteteve doganore dhe jodoganore, eliminimit të dokumenteve fizikë, reduktimit të kohës së pritjes, dhe shmangies së kërkesave të përsëritura nga institucione të ndryshme.
9. **Integrim 100% i sistemeve të autoriteteve doganore me sistemet e autoriteteve** të tjera kompetente bashkërenduese që lëshojnë dokumente të nevojshme për zhdoganimin.
10. **Sigurimi i një ndërveprimi të plotë, të qëndrueshëm dhe të automatizuar**, duke përfshirë shkëmbimin automatik të të dhënave, verifikimin në kohë reale të autorizimeve, certifikatave dhe licencave, si dhe eliminimin e dorëzimit fizik ose manual të dokumenteve nga operatorët ekonomikë.
11. **Reduktimi i dokumenteve fizike të kërkuara** për formalitetet doganore dhe jodoganore, përmes shkëmbimit automatik dhe verifikimit elektronik të të dhënave mes sistemeve.
12. **Rritja e cilësisë së shërbimit** përmes ofrimit të mekanizmave të matshëm të vlerësimit, për identifikimin e vonesave, pikave problematike, praktikave të paunifikuara dhe ndërmarrjes së korrigjimeve.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë marrë në shqyrtim për krijimin e një Dritareje të Vetme Kombëtare për Doganat në Republikën e Shqipërisë:

Opsioni 0 (status quo): nënkupton vijimin me ligjin aktual. Në legjislacionin aktual nuk ka të parashkuar një ligj për krijimin dhe funksionimin e një Dritare të Vetme Kombëtare për Doganat dhe për pasojë ky opsion nuk mund të aplikohet. Kjo nisëm përbën një domosdoshmëri për plotësimin e kuadrit ligjor në këtë fushë dhe arritjen e objektivave të synuara si më lartë.

Opsioni 0 (status-quo) nuk mund të aplikohet, pasi nisma për krijimin dhe funksionimin e një Dritare të Vetme Kombëtare për Doganat (DVKD), si një prej komponentëve të *“Projektit për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor, me një qasje programore me shumë-faza”*, është një risi, që nuk mund të realizohet pa krijimin e bazës ligjore të nevojshme. Krijimi dhe funksionimi i DVKD duhet të parashikohet në legjislacionin e brendshëm.

Megjithëse kostot afatshkurtra të opsionit 0 janë formalisht të ulëta (0), pasi nuk pritet ndryshim ligjor, ose investim i menjëhershëm. Kostot afatgjata janë të konsiderueshme, sepse moskrijimi i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat sjell humbje të mundësive për modernizim, rritje të kostove për bizneset dhe vonesa të vazhdueshme në procedurat doganore. Në terma afatgjatë, ekonomia dhe tregtia shqiptare mbeten më pak konkurruese, nëse nuk ndërmerret kjo nisëm.

Në mungesë të një kuadri ligjor të ri, çdo institucion vazhdon të funksionojë sipas rregullave dhe sistemeve të brendshme dhe nuk mund të vendosen standarde të përbashkëta për dokumentet dhe formatet e të dhënave, duke krijuar kështu një situatë ku Dritarja e Vetme nuk mund të operojë as teknikisht dhe as funksionalisht. Mungesa e kësaj reforme ligjore ruan varësinë nga proceset manuale, duke penguar modernizimin e sistemit doganor. Kjo do të sillte jo vetëm mosrealizim të objektivave të projektit rajonal për Lehtësimin e Tregtisë në Ballkanin Perëndimor, por edhe mungesën e harmonizimit me praktikën e Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare për *“Single Window”*. Për këtë arsye, vijimi me situatën aktuale është joefektiv, jo i qëndrueshëm dhe jo në përputhje me nevojat strategjike për modernizimin e shërbimeve doganore.

Opsioni 1 (jorregullator):- nënkupton marrjen e masave jorregullatore si kryerja e fushatave ndërgjegjëse dhe rritja e kontroleve. Ky opsion nuk është i përshtatshëm për t’u zbatuar, pasi problematikat e evidentuara nuk mund të trajtohen nëpërmjet këtyre masave, por kërkohet një rregullim ligjor. Për më tepër problematikat aktuale janë të natyrës rregullatore, jo informuese dhe nuk mund të zgjidhen me masa jorregullatore.

Duke qenë se Dritarja e Vetme Kombëtare për Doganat nënkupton ngritjen e një sistemi të unifikuar, ndërveprues dhe të standardizuar ligjorisht, kjo nisëm nuk mund të arrihet me

masa jorregullatore të përkohshme, por kërkon një ndërhyrje të qartë në legjislacion. Asnjë fushatë informimi apo rritje e kontroleve nuk mund të zëvendësojë mungesën e një ligji të posaçëm që përcakton detyrimet e qarta të institucioneve, mënyrën e shkëmbimit të detyrueshëm të të dhënave, si dhe standardet e harmonizuara të dokumenteve dhe procedurave.

Ky opsion nuk redukton pengesat, por zbatimi i tij do të vijonte të sillte të njëjta problematika si dublimi i proceseve, kërkesave të përsëritura për dokumente, verifikime të shumëfishta dhe vonesa në proceset e zhdoganimit. Ky opsion nuk do të sillte asnjë përmirësim substancial në rritjen e efikasitetit administrativ, procedurat e zhdoganimit apo në lehtësimin e tregtisë, pasi këto përfitime kërkojnë ndryshime të qarta ligjore, të cilat masat jorregullatore nuk i ofrojnë.

Për më tepër, standardet e Bashkimit Evropian për “Single Window”, kërkojnë në mënyrë të qartë që krijimi dhe funksionimi i Dritares së Vetme të mbështetet në një bazë specifike ligjore dhe jo në masa të pjesshme apo vullnetare. Pa një kornizë të detyrueshme ligjore, kjo do të ndikonte në mospërmbyshjen e detyrimeve ndërkombëtare dhe integrimin me sistemet e avancuara të BE-së për lehtësimin e tregtisë.

Ky opsion mund të sjellë disa përfitime të pjesshme si vijon:

Kosto të ulëta afatshkurtra - Masat jorregullatore (fushata informuese, udhëzime të brendshme, koordinime operative) kanë kosto minimale ose të ulëta krahasuar me ndërhyrjet ligjore dhe teknike

Përmirësime të kufizuara në praktikat aktuale - Mund të ndihmojë për të qartësuar disa procedura ose për të reduktuar disa vonesa përmes koordinimit manual, por vetëm në një shkallë shumë të kufizuar.

Fleksibilitet organizativ i përkohshëm - Institucionet mund të testojnë pilote të vogla operationale (workflow të përditësuar, modele dokumentesh) pa barrën e detyrimeve ligjore të menjëhershme. Kjo ofron të dhëna paraprake për dizajnin e ardhshëm ligjor/teknik.

Së fundi, edhe pse ky opsion sjellë disa përfitime të pjesësme të evidentuara si më lartë, është i paqëndrueshëm dhe me ndikim minimal afatgjatë. Për këtë arsye, Opsioni 1 konsiderohet i pamjaftueshëm, joefektiv dhe i papërshtatshëm për arritjen e objektivave strategjike të reformës në tregtinë ndërkufitare dhe modernizimin e shërbimeve doganore.

Opsioni 2 (rregullator):– nënkupton ndryshimin e ligjit nr. 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”, ose Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, si ligje ku mund të përshtaten këto ndryshime, pasi në legjislacionin aktual nuk ka një ligj specifik për krijimin e një Dritare të Vetme Kombëtare për Doganat.

Në listën e propozimeve të bëra në raportin përfundimtar “*Blueprint*” të Bankës Botërore, mbi kuadrin ligjor dhe rregullator në Republikën e Shqipërisë, për Krijimin e DVKD, në

rekomandimin **TC1-1**, rekomandohet që Shqipëria të ketë një bazë ligjore formale, të detajuar, për krijimin dhe funksionimin e DVKD.

Nëse do të propozohet që kjo nisëm të arrihet përmes një ndryshimi në ligjin nr. 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”, ku përkatësisht në nenin 10, të shtohet një pikë e re (4) që shprehet për krijimin e DVK. Funksionimi i DVK më pas do të bëhet përmes një VKM të re.

Ndryshimi i ligjit nr. 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë” nuk është një opsion i përshtatshëm për krijimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, sepse ky ligj është hartuar në funksion dhe objekt krejtësisht të ndryshëm nga modeli i DVKD. Ligji për shërbimet synon rregullimin e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe bizneseve në kuptimin e procedurave administrative të përgjithshme, ndërsa DVKD është një mekanizëm, i cili kërkon standarde teknike, procedurale dhe juridike të integruara midis autoriteteve doganore dhe institucioneve të tjera kompetente. Vendosja e një sistemi të specializuar brenda një ligji kaq të gjerë do të krijonte mospërputhje konceptuale dhe konflikt kompetencash, sepse dispozitat e ligjit ekzistues nuk ofrojnë hapësirat e nevojshme për të përshkruar të gjitha komponentët organizativë, teknologjikë dhe rregullatorë që kërkon DVKD. Për m

Një tjetër problem thelbësor është se edhe nëse do të kryhet ndryshimi në Kodin Doganor, e kufizon funksionalisht DVKD, sepse nuk mund të përfshijë të gjitha organet bashkërenduese që marrin pjesë në këtë proces. Këto elemente nuk mund të përfshihen me një shtesë nenesh të një ligji ekzistues, sepse kjo nisëm kërkon një rregullim më specifik dhe të detajuar.

Shtimi i dispozitave të reja në ligjet ekzistuese krijon gjithashtu rrezik të lartë për fragmentim dhe interpretim subjektiv. Pa një ligj të veçantë, i cili i përshkruan qartë kompetencat, rolet, organet menaxhuese, përgjegjësitë dhe mekanizmat e bashkërendimit, institucionet rrezikojnë ta interpretojnë DVKD në mënyrë të ndryshme – çka sjell zbatim të pabarabartë, standarde të ndryshme dokumentare dhe moskoordinim të proceseve. Sipas këtij opsioni, DVKD do të funksiononte vetëm si një platformë teknike e pjesshme, pa u shndërruar në mekanizmin e unifikuar ligjor.

Gjithashtu, një ndryshim në ligj ekzistues nuk përmbush rekomandimet e Bankës Botërore, të cilat kërkojnë qartësisht një bazë ligjore të dedikuar, të detajuar dhe të harmonizuar për DVKD, në përputhje me rekomandimin TC1-1 të raportit përfundimtar “Blueprint”. Për pasojë, ndryshimi i ligjeve të tjera nuk do të siguronte nivelin e saktësisë dhe detajimit që kërkojnë këto standarde ndërkombëtare.

Edhe pse ky opsion paraqet disa avantazhe si vijon:

- Proces më i shpejtë se krijimi i një ligji të ri - Ndryshimi i një ligji ekzistues mund të kalojë më shpejt në proces konsultimi dhe miratimi sesa hartimi i një ligji të ri.
- Mund të përdoret si zgjidhje tranzitore - Një ndryshim minimal në një ligj ekzistues mund të krijojë një bazë relativisht të shpejtë, mbi të cilën më pas të nxirret një VKM për funksionimin e DVKD.

- Lehtëson harmonizimin e pjesshëm në një fazë të parë - Institucionet do të kenë të paktën një referencë ligjore për DVKD, edhe nëse jo të plotë
- Kosto më të ulët në terma teknikë lidhur me hartimin- Ndryshimet e pjesshme kërkojnë më pak burime njerëzore, më pak kohë dhe konsultime më të fokusuara.

Në përfundim, Opsioni 2 paraqet rrezikun e krijimit të një sistemi të jo të mirëpërcaktuar, të paqartë dhe të kufizuar, i cili nuk ofron bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e plotë të Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat. Për këtë arsye, ky opsion vlerësohet si jo i përshtatshëm dhe jo i mjaftueshëm për të mbështetur rëndësinë e kësaj nisme.

Opsioni 3 (rregullator) i preferuar: – Miratimi i një ligji për krijimin dhe funksionimin një Dritare të Vetme Kombëtare për Doganat, është opsioni më i përshtatshëm për adresimin e problematikave dhe realizimin e objektivave të përmendur si më sipër.

Realizimi i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganën nuk është vetëm një ndryshim teknik, por një reformë gjithëpërfshirëse institucionale dhe ligjore. Kjo nisëm përfshin ndërhyrje në disa nivele:

1. Ligjor dhe rregullator: Nevojiten ndryshime të thella në kuadrin ligjor vendas, për të krijuar bazën e nevojshme për funksionimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat dhe për të garantuar harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian dhe Marrëveshjen CEFTA. Argumentuar në vijim të këtij opsioni.

2. Institucional dhe organizativ: Krijimi i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganën kërkon koordinim të vazhdueshëm midis doganave dhe autoriteteve të tjera kompetente, për të integruar procedurat, për të reduktuar fragmentimin dhe përsëritjen e informacionit, si dhe për të rritur efikasitetin e vendimmarrjes ndërinstitutionale.

Në listën e propozimeve të bëra në raportin përfundimtar “*Blueprint*” të Bankës Botërore, mbi kuadrin ligjor dhe rregullator në Republikën e Shqipërisë, për Krijimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, në rekomandimin TC1-1, rekomandohet që Shqipëria të ketë një bazë ligjore formale, të detajuar, për krijimin dhe funksionimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.

Gjithashtu, më 23 Nëntor 2022 hyri në fuqi Rregullorja e BE 2022/2399 për “Krijimin e Mjedisit të Dritares së Vetme të Bashkimit Evropian për Doganat dhe ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 952/2013” (*e cila tashmë është zëvendësuar nga Rregullorja e BE 2024/2514 e datës 3 Korrik 2024*). Kjo Rregullore, trajton në mënyrë të detajuar kriteret për ngritjen dhe funksionimin e Dritares së Vetme për Doganat në BE, rregullat për shkëmbimin e të dhënave përmes sistemit me një dritare për doganën dhe sistemeve jo-doganore të BE, sjell koncepte të reja në këtë fushë të cilat revolucionojnë terminologjinë e përdorur deri tani, si dhe sjell nevojën për ndryshime në Kodin Doganor të Unionit.

Krijimi i DVKD sjell nevojën për përfshirjen e koncepteve të reja, rregulla dhe elementë të rinj të bashkëpunimit digjital mes autoriteteve kompetente bashkërenduese (AKB), rregulla

të ndërveprimit të vetë Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat me sistemin e BE CSW-CERTEX, etj, gjithashtu lind nevoja për përafrimin e Rregullores BE 2022/2399 në legjislacionin e brendshëm. Për këtë arsye, konsiderohet e arsyeshme të ndiqet Opsioni 3, pra që rregullimi i këtyre koncepteve komplekse të bëhet përmes një projektligji të ri për krijimin dhe funksionimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.

Avantazhet e këtij opsioni

Ky opsion siguron një baza të qartë dhe të unifikuar ligjore, e cila është e nevojshme për funksionimin e një mekanizmi kompleks, ndërinstitutional dhe digjital siç është DVKD.

Miratimi i nismës së propozuar me një ligji të veçantë eliminon çdo paqartësi juridike dhe krijon siguri të plotë ligjore si për institucionet publike ashtu edhe për operatorët ekonomikë. Ky opsion ndikon që të gjitha institucionet jenë të detyruara të zbatojnë procedurat, të bashkërendojnë vendimmarrjen, të shkëmbejnë të dhëna në kohë reale dhe të harmonizojnë dokumentet dhe autorizimet e tyre. Kjo shmang interpretimet subjektive, fragmentimin institutionel dhe boshllëqet normative që do të shfaqeshin nëse DVKD do të themelohej vetëm me një akt nënligjor.

Për më tepër, ky opsion implementon plotësisht rekomandimin TC1-1 të raportit përfundimtar Blueprint të Bankës Botërore, i cili kërkon shprehimisht që krijimi i një Single Window të mbështetet në një bazë të detajuar dhe specifike ligjore — dhe jo në ndryshime të pjesshme apo dispozita të vendosura në ligje të tjera me objekt të ndryshëm.

Një tjetër avantazh themelor është fakti që ligji i ri mundëson përafrim të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përfshirë rregulloren 2022/2399 dhe aktet e tjera të politikës doganore të BE-së për krijimin e një “mjedisi të vetëm doganor”, si dhe rregullat për shkëmbimin e të dhënave doganore dhe jo-doganore.

Ligji krijon gjithashtu një bazë të përshtatshme për aktet nënligjore, të cilat më pas mund të detajojnë funksionimin praktik të DVKD. Ligji përcakton parimet, rolet, përgjegjësitë dhe mekanizmat e bashkërendimit; ndërkohë që aktet nënligjore mund të adresojnë aspektet procedurale, teknologjike dhe operacionale në mënyrë të detajuar, të harmonizuar dhe të zbatueshme.

Po ashtu, nisma për miratimin e një ligji të ri parandalon konfliktet institucionale dhe mbivendosjet me ligjet e tjera, si ligji doganor, ligjet për sigurinë ushqimore, mbrojtjen e bimëve, shëndetin e kafshëve, standardet teknike apo tregtinë. Nëse DVKD do të vendosej në mënyrë të fragmentuar brenda ligjeve ekzistuese, kjo do të krijonte mbivendosje juridike dhe pasiguri në zbatimin e kompetencave. Vetëm një instrument ligjor i veçantë mund të garantojë një bazë të qartë normative dhe të qëndrueshme me rregulla të unifikuara dhe të detyrueshme.

Disavantazhet: Proces më i gjatë - Hartimi, konsultimi dhe miratimi i një ligji kërkon kohë të shtuar dhe kalim në disa faza procedurale (konsultim publik, dakordësim ndërinstitutional, diskutim në komisione parlamentare, votim në Kuvend).

Koordinim ndërinstitutional - Përgatitja e ligjit kërkon përfshirjen e shumë aktorëve (ministri linje, institucione të AKB-ve, sektorë IT, juridikë, partnerë ndërkombëtarë). Për këtë arsye ky proces kërkon më tepër kohë dhe koordinim të vazhdueshëm me të gjitha institucionet deri në finalizimin e kësaj nisme.

Ligji në krahasim me një VKM kërkon ekspertizë juridike dhe teknike si dhe analiza të ndikimit dhe konsultime të gjera me palët e përfshira.

Së fundmi, arrihet në përfundimin se miratimi i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat vetëm me një VKM do të ishte i pamjaftueshëm dhe me risk të lartë, ndërsa rruga e vetme që garanton, sigurinë juridike dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemit është miratimi i një ligji të posaçëm të integruar.

Një tjetër opsioni është miratimi i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave, por ky opsion është i papërshtatshëm.

Avantazhet: Miratim më i shpejtë - VKM ka një proces më të thjeshtë dhe më të shpejtë miratimi sesa miratimi i kësaj nisme me një projektligj që duhet të kalojë në një procedurë më të gjatë.

Fleksibilitet më i lartë për ndryshime - VKM mund të ndryshohet më shpejt në rast se paraqiten vështirësi teknike, apo ka nevojë për rishikime procedurale, ndërsa një ligj për t'u ndryshuar kërkon një procedurë më të gjatë.

Procesi i hartimit dhe miratimit të VKM-së kërkon më pak burime njerëzore, më pak konsultime, si dhe më pak procedura, në krahasim me një projektligj.

Disavantazhet: Mungesë e një baze ligjore të plotë. Në rast se kjo nisëm do të miratohej me një VKM, atëherë duke qenë se kjo reformë prek shumë institucione, VKM do të ishte i pamjaftueshëm për të krijuar një bazë të plotë dhe specifike për funksionimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.

Nuk krijon bazën e detajuar të kërkuar nga standardet ndërkombëtare - *Blueprint* i Bankës Botërore rekomandon shprehimisht krijimin e një baze ligjore formale, të detajuar dhe të veçantë për DVKD. VKM nuk përmbush standardet e përcaktuara nga Rregullorja e BE 2022/2399, si dhe praktikat e Mjedisit të Dritares së Vetme të BE-së.

Nuk rregullon në mënyrë të mjaftueshme rolet, përgjegjësitë dhe detyrimet ligjore të Autoriteteve të tjera kompetente bashkërenduese. Duke qenë se Dritarja e Vetme Kombëtare për Doganat është një nisëm që prek disa institucione, VKM do të ishte një mjet i pamjaftueshëm për të bërë një rregullim të plotë të kësaj nisme.

Rrezik i lartë për boshllëqe normative – Në rast se kjo nisëm miratohet me VKM mund të lindin boshllëqe të tilla si: konflikt me ligjin doganor, mungesë detyrimi për AKB-të, paqartësi procedurale për operatorët ekonomikë.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike

- **Rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare** – Krijimi i një Dritareje të Vetme Kombëtare për Doganat redukton kohën dhe kostot e procedurave të tregtisë. Integrimi i procedurave doganore në një platformë të unifikuar mundëson kalime më të shpejta kufitare dhe transport më efikas, që ndihmon bizneset shqiptare të furnizohen dhe të eksportojnë më shpejt. Kjo nxit zhvillimin e logjistikës kombëtare, rrit vëllimin e tregtisë rajonale dhe krijon një klimë më të favorshme për investime.
- **Ulja e kostove administrative** – Dixhitalizimi dhe centralizimi i procedurave eliminojnë përsëritjen e dokumentacionit dhe kontrolleve, duke sjellë ulje të ndjeshme të shpenzimeve për logjistikë.
- **Rritja e efikasitetit të zinxhirit të furnizimit** – Mallrat qarkullojnë më shpejt dhe më lirë, çka ul çmimet dhe përmirëson konkurrencën në tregun vendas.
- **Formalizimi i ekonomisë** – Sistemet e integruara doganore rrisin kontrollin mbi mallrat dhe transaksionet ndërkufitare, duke ulur informalitetin dhe evazionin fiskal.
- **Përmirësim i klimës së biznesit**– Duke qenë se procedurat e digjitalizuara ulin hapësirën për ndërhyrje subjektive dhe vendime të paarsyetuara. Kjo do të ndikojë në rritje të sigurisë juridike, reduktim të riskut të biznesit, rritje të investimeve vendase.
- **Nxitje e investimeve të huaja.** Duke qenë se nga investitorët e huaj kërkohen procedura të shpejta dhe të dixhitalizuara, proces transparent, kostot të ulëta të transportit dhe operimit, si dhe siguri ligjore, kjo nismë do të ndikojë në krijimin e një sistemi modern, rritjen e besimit në institucionet publike, si dhe e pozicionon Shqipërinë si destinacion më tërheqës për investime të huaja, duke ndikuar në rritjen e këtyre investimeve.
- **Përmirësi i tregtisë.** Standardizimi redukton pengesat administrative, dhe në këtë mënyrë kjo nismë do të ndikojë në rritjen e eksporteve, si dhe valorizim të prodhimit vendas.

Ndikimet në sektorin publik

- **Koordinim ndërinstitutional** – Integrimi i të gjitha agjencive shtetërore në një platformë të vetme (dogana, autoritete fitosanitare, veterinare, shëndetësore, etj.) përmirëson bashkëpunimin dhe redukton mbivendosjet e kompetencave.
- Vendosi mekanizma të qartë koordinimi ndërmjet autoriteteve doganore dhe Autoriteteve të tjera Kompetente Bashkërenduese, duke reduktuar fragmentimin vertikal/horizontal.
- I bën të detyrueshme standardet, afatet, dhe formatet për të gjitha institucionet publike që lëshojnë dokumente jodoganore (leje, licenca, autorizime).

- **Transparencë dhe përgjegjshmëri më e lartë** – Sistemi i unifikuar dixhital gjurmon çdo hap të procedurave dhe redukton hapësirën për korrupsion dhe vendimmarrje subjektive.
- **Përmirësim i mbledhjes së të ardhurave** – Sistemi elektronik i integruar rrit efikasitetin e kontrollit dhe zvogëlon mundësinë e humbjes së të ardhurave fiskale.
- **Përshtatje me standardet e BE-së dhe tregun e përbashkët evropian** – Harmonizimi i procedurave me praktikën më të mira ndërkombëtare e afron Shqipërinë me standardet e integritetit evropian.
- **Kapacitet më i mirë analitik** – Të dhënat e centralizuara mundësojnë analiza më të thelluara për politikën tregtare dhe përmirësimin e kontrollit të rrezikut.
- **Standardizimi i proceseve – Procese të standardizuara duke filluar nga kërkesa deri te vendimi, me role/afate të standardizuara.** Kjo ndikon në uljen ndjeshëm të kohës së përgjigjes, si dhe eliminon kërkimet e të njëjtit dokument nga institucione të ndryshme, pasi ky sistem përdor të dhëna nga “burimi zyrtar”.
- **Transformim digjital ku intergrimi i sistemeve** lidhja e sistemit bazë me regjistrat bazë (Regjistrin e Bizneseve, Bujqësi, Mjedis, Certifikata cilësie etj.) ndikon në rrjedhën e pandërprerë e të dhënave, si dhe reduktim të kohës që kërkohet për këto procedura në rast se do të zhvillohen manualisht.

Ndikimet në sektorin privat

- **Lehtësim i procedurave për bizneset** – Operatorët ekonomikë dhe kompanitë importuese/eksportuese dorëzojnë dokumentacion vetëm një herë në një sistem të vetëm, duke kursyer kohë dhe burime.
- **Reduktim i kostove operative** – Më pak tarifa administrative, më pak vonesa dhe më pak inspektime të përsëritura sjellin kursime direkte për kompanitë, duke qenë se shmanget dorëzimi i dokumentave të njëjtja disa herë në institucione të ndryshme.
- **Siguri më e madhe juridike** – Procedurat e qarta dhe të unifikuara garantojnë parashikueshmëri dhe reduktojnë pasigurinë në zinxhirin e furnizimit.
- **Shpejtim i procedurave të importit, eksportit dhe tranzitit** - Dorëzimi i vetëm një herë i dokumenteve redukton ndjeshëm kohën e përpunimit të deklaratave doganore.
- **Rritja e transparencës** – ku çdo biznes ka mundësi të ndjekë online statusin e procedurave doganore.
- **Lehtësimi i tregtisë**, ku kjo nismë do të ndikojë edhe në rritjen e aftësisë eksportuese të sektorit privat, sidomos në industri ku koha është faktor kyç (agroushqim, tekstile, prodhim). Për më tepër, ndërveprimi i thjeshtuar me autoritetet i afron bizneset shqiptare me standardet ndërkombëtare të tregtisë.
- **Mundësi më të mëdha për investime të huaja** – Një sistem modern dhe transparent doganor është më tërheqës për investitorët e huaj.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar është Opsioni 3, pra miratimi i një ligji të ri i cili do të ofrojë rregullimin e duhur për “Për Krijimin dhe Funksionimin e DVKD” në Republikën e Shqipërisë.

Arsyet e përzgjedhjes së këtij opsioni, si opsioni i preferuar janë si më poshtë vijon:

- **Siguron bazën e nevojshme juridike për funksionimin** e kësaj dritare. Për më tepër kjo nismë është një iniciativë që lidhet me harmonizimin e *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian për EU Customs Single Ëindoë Environment dhe ky harmonizim kërkon ndërveprim të detyrueshëm mes sistemeve, unifikim të procedurave, përgjegjësi të qarta institucionale, si dhe mekanizma monitorimi - që vetëm ligji mund t’i garantojë. Kjo e bën Shqipërinë kompatible me BE-në dhe rrit aftësinë për integrim të plotë në sistemet doganore europiane.
- **Adreson drejtpërdrejtë problematikat.** Duke qenë se aktualisht procedurat jodoganore shpërndahen në një numër të lartë institucioneve, si dhe sisteme të ndryshme, kjo shkakton në disa raste vonesa, kosto të larta, si dhe duplikim dokumentesh. Në këtë mënyrë nisma e propozuar nëpërmjet miratimit me një ligj krijon një kornizë të vetme dhe të detyrueshme për standardizim, integrim të plotë teknologjik, shkëmbim të automatizuar të informacionit, si dhe përgjegjësi të qarta dhe të matshme për çdo institucion. Ky është opsioni i vetëm që zgjidh problemin në mënyrë strukturore, jo pjesore.
- **Garantimi i qëndrueshmërisë institucionale dhe teknike.** Nëse nuk do të ndërmerret iniciativa për miratimin e një ligji, atëherë ky sistem do të përballej me disa sfida si: do të varej nga vullneti i institucioneve, rrezikohej fragmentimi i ardhshëm, do mungonte detyrimi për mirëmbajtje, si dhe do të mungonin mekanizma për monitorim. Iniciativa për miratimin e kësaj nisme nëpërmjet një ligji i detyron institucionet të bashkëveprojnë me sistemin, krijon një organ të përhershëm koordinues, si dhe vendos mekanizma monitorimi. Pra, garanton funksionim afatgjatë dhe të qëndrueshëm.
- **Redukton ndjeshëm kostot ekonomike dhe kohën e procedurave.** Nëse nuk do të ndërmerret iniciativa për miratimin e një ligji, bizneset dhe qytetarët do të përballen me procedura të fragmentuara, kosto të larta logjistike, si dhe në disa raste me vonesa në zhdoganime. Nisma e propozuar krijon proces të unifikuar elektronik, eliminimin e kontakteve fizike dhe dokumenteve në letër. Kjo ndikon në uljen ndjeshëm të kohës së zhdoganimit, uljen e kostove të magazinimit, transportit dhe operimit, rrit qarkullimin e mallrave, si dhe rrit konkurrueshmërinë e ekonomisë.
- **Përmirëson ndjeshëm transparencën.** Sistemi elektronik i propozuar me një bazë ligjore të mirëpërcaktuar siguron gjurmueshmëri të plotë të çdo veprimi, vendime të dokumentuara elektronikisht, minimizim të kontakteve fizike, si dhe reduktim të diskrecionit administrativ.

- **Krijon kushte më të mira për investime të huaja.** Duke qenë se investitorët e huaj kërkojnë procedura të thjeshta, siguri juridike, dhe transparencë. Nisma e popozuar rrit besueshmërinë e administratës, ulët burokracia, zvogëlon kostot, thjeshton tregtinë ndërkombëtare, si dhe rrit shpejtësinë e operimeve logjistike. Kështu, nisma e propozuar rrit aftësinë e Shqipërisë për të tërhequr investime të huaja konkurruese.
- **Nisma ligjore krijon bazën** që të gjitha të dhënat doganore dhe jodoganore të jenë të integruara, të krahasueshme dhe të standardizuara. Kjo mundëson identifikim të sektorëve me problematika, si dhe planifikim strategjik mbi baza të dhënash reale.
- **Nisma e propozuar sjell lehtësimin e procedurave doganore** të importit, eksportit dhe tranzitit, me dokumenta të standartizuara në një pikë të vetme. Krijimi i një Dritareje të Vetme Kombëtare për Doganat redukton kohën dhe kostot e procedurave të tregtisë.
- **Integrimi i procedurave doganore në një platformë të unifikuar** mundëson kalime më të shpejta kufitare dhe transport më efikas, që ndihmon bizneset shqiptare të furnizohen dhe të eksportojnë më shpejt. Kjo nxit zhvillimin e logjistikës kombëtare, rrit vëllimin e tregtisë rajonale dhe krijon një klimë më të favorshme për investime.
- **Koordinim ndërinstytucional** – Integrimi i të gjitha agjencive/institucioneve shtetërore në një platformë të vetme (dogana, autoritete fitosanitare, veterinarë, shëndetësore, etj.) sipas kësaj nisme përmirëson bashkëpunimin dhe redukton mbivendosjet e kompetencave

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Nisma e propozuar është diskutuar në takime konsultative të zhvilluara me autoritetet kompetente bashkërenduese, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve si Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përfaqësues të Komitetit Drejtues për zbatimin e projektit “*Lehtësimi i tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor duke përdorur qasjen programatike me shumë faza*”, si dhe me përfaqësues të shoqatave të biznesit.

Nisma e propozuar i është nënshtruar edhe procesit të konsultimit publik, ku është publikuar në datë 26.01.2026 në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimin Publik, deri në datë 23.02.2026. Kjo nismë ka patur numër të lartë shikimesh, rreth 513 shikime. Ndërsa lidhur me komentet, ka patur vetëm një koment si më poshtë vijon:

Single Window është ajo që në shqip është përdorur "sportel unik". Pra në vend të "dritares së vetme" sugjeroj përdorimin e termit të harmonizuar "sportel unik". Ky koment nuk është marrë parasysh duke qenë se nisma e propozuar është në përshtatje me terminologjinë e përdorur nga Bashkimi Evropian.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Institucionet dhe organet që kanë përgjegjësi dhe detyra lidhur me Dritaren e Vetme Kombëtare për Doganat janë:

- a) Ministri përgjegjës për financat;
- b) Komiteti Mbikëqyrës i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat;
- c) Koordinator Kombëtar;
- d) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- e) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- f) Autoritetet Kompetente Bashkërenduese;
- g) Operatorët Ekonomikë.

Ministri përgjegjës për financat me propozim të Komitetit Mbikëqyrës së Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, miraton me udhëzim, si vijon:

- a) elementet e të dhënave të përbashkëta dhe të dhënat shtesë që shkëmbehen përmes Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat;
- b) rregullat e veçanta të shkëmbimit të informacionit për formalitetet jodoganore;
- c) masat për standardet e garantimit të mbrojtjes së të dhënave personale në këtë proces;
- d) procedura dhe rregulla për zbatimin e këtij neni.

Komiteti Mbikëqyrës për Dritaren e Vetme Kombëtare për Doganat është organ kolegjal bashkërendues i cili krijohet me urdhër të ministrit përgjegjës për financat dhe përbëhet:

- a) 3 përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për financat,
- b) 1 përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për tregtinë,
- c) Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe 3 përfaqësues të tjerë;
- d) Titullari i institucionit përgjegjës për infrastrukturën e shërbimeve të qeverisjes elektronike dhe ofrimin e shërbimeve elektronike TIK;
- e) Titullarët e Autoriteteve Kompetente Bashkërenduese;
- f) 3 përfaqësues të shoqatave të biznesit, aktiviteti i të cilëve lidhet me tregtinë ndërkombëtare.

Komiteti Mbikëqyrës për Dritaren e Vetme Kombëtare për Doganat kryesohet nga Koordinatori Kombëtar.

Komiteti Mbikëqyrës i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të proceseve administrative dhe teknike të Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, çështjeve për lehtësimin e tregtisë të lidhura me rregullat dhe procedurat doganore dhe zbatimit të formaliteteve jodoganore sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj.

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Komitetit Mbikëqyrës miratohet nga ministri përgjegjës për financat me propozimin e Komitetit Mbikëqyrës.

Komiteti Mbikëqyrës shqyrton dhe trajton të gjitha çështjet që lidhen me funksionimin dhe mbarëvajtjen e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.

Komiteti Mbikëqyrës propozon ndryshimet në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse pranë ministrive të linjës, për formalitetet jodoganore që integrohen në mjedisin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, me qëllim përshtatjen e këtij legjislacioni me Kodin Doganor dhe standardet ndërkombëtare. Ai gjithashtu propozon rregullat për popullimin e të dhënave, për lidhjen e sistemeve jodoganore në mjedisin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat dhe për përmbushjen e formaliteteve jodoganore përkatëse, si dhe për administrimin dhe përdorimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat nga Autoritetet Kompetente Bashkërenduese.

Komiteti Mbikëqyrës ndërmjetëson zgjidhjen e mosmarrëveshjeve teknike ose/dhe administrative midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe autoriteteve kompetente bashkërenduese.

Komiteti Mbikëqyrës, vlerëson dhe vendos për periudhën e aplikimit të tarifave të përdorimit të sistemit elektronik me një Dritare të Vetme Kombëtare për Doganat për shkëmbimin e dokumenteve mbështetëse dhe kategoritë e përdoruesve të këtij sistemi, pasi ky sistem të ngrihet dhe të funksionojë. Këto tarifa shërbimi caktohen duke mbajtur parasysh mbulimin e kostove të nevojshme për mirëmbajtjen e sistemit elektronik, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Komiteti Mbikëqyrës ka të drejtën e përfitimit të shpërblimit për mbledhjet e zhvilluara. Masa e shpërblimit dhe numri maksimal i mbledhjeve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave cakton përbërjen dhe funksionet e sekretariatit teknik të Komitetit Mbikëqyrës.

Koordinatori Kombëtar i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat është nivel i lartë drejtues dhe caktohet me urdhër nga ministri përgjegjës për financat dhe kryen detyrat e mëposhtme:

- a) vepron si pikë kombëtare kontakti për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e dispozitave të këtij ligji;
- b) promovon dhe mbështet në nivel kombëtar, bashkëpunimin ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, autoriteteve kompetente bashkërenduese dhe komunitetit të biznesit për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;
- c) koordinon të gjitha aktivitetet dhe problematikat në lidhje me funksionimin dhe ndërveprimin e mjedisit të DVKD-së në Republikën e Shqipërisë me BE CSË-CERTEX.

Koordinatori Kombëtar i paraqet ministrit përgjegjës për financat dhe Këshillit të Ministrave brenda 3 mujorit të parë të vitit pasardhës raport mbi zbatimin e këtij ligji, i cili përfshin:

- a) pasqyrën e formaliteteve jodoganore të autoriteteve kompetente bashkërenduese të përfshira në legjislacionin në fuqi dhe propozimet për ndryshimet ligjore përkatëse nëse është e nevojshme;
- b) ecurinë e përdorimit dhe funksionimit të Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat në lidhje me zbatimin e këtij ligji;
- c) një pasqyrë të detajuar të progresit të përgjithshëm të arritur në Dritaren e Vetme Kombëtare për Doganat në lidhje me planin e punës për lidhjen e sistemeve jodoganore me mjedisin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat;
- d) informacione të tjera që lidhen me sfidat dhe komunikimin ndër-institucional;
- e) sipas rastit, indikatorët mbi ndikimin tek operatorët ekonomikë, në veçanti në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe lehtësimin e tregtisë.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave është autoriteti përgjegjës për Dritaren e Vetme Kombëtare për Doganat dhe ka këto përgjegjësi:

- a) Mbikëqyr funksionimin e përgjithshëm të mjedisit të Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat dhe zbatimin korrekt të procedurave doganore për dokumentacionin që administrohet nëpërmjet DVKD.
- b) Përdor mjedisin e Dritaressë Vetme Kombëtare për Doganat për verifikimin e automatizuar të formaliteteve doganore dhe jodoganore, bazuar në shkëmbimin e të dhënave me autoritetet kompetente bashkërenduese.
- c) Përdor të dhënat e marra, nga autoritetet bashkërenduese, përmes sistemit, për menaxhimin e sasisë së mallrave të autorizuar nga ana e tyre.
- d) Koordinon kontrollat me autoritetet e tjera, kur është e nevojshme, duke përdorur këtë mjedis si një mjet për shkëmbimin e informacionit.
- e) Vepron si kontrollues i përbashkët i të dhënave personale, së bashku me autoritetet kompetente bashkërenduese, për të dhënat e përpunuara në DVKD.

Institucioni përgjegjës për infrastrukturën e shërbimeve të qeverisjes elektronike dhe ofrimin e shërbimeve elektronike TIK në Republikën e Shqipërisë, është Operatori i mjedisit Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat dhe ka këto përgjegjësi:

- a) Krijon, zhvillon, integron dhe siguron funksionimin e pandërprerë teknik të platformës së Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.
- b) Garanton sigurinë kibernetike, integritetin dhe disponueshmërinë e sistemit dhe të dhënave që përpunohen në të, në përputhje me standardet më të larta teknike.
- c) Siguron ndërveprueshmërinë teknike midis sistemeve elektronike të Autoritetit Doganor dhe atyre të autoriteve kompetente bashkërenduese.
- d) Mirëmban dhe përditëson sistemin në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe kërkesat e reja ligjore.
- e) Raporton dhe mban të informuar të gjitha autoritetet përgjegjëse lidhur me problematikat e shfaqura në kohë reale dhe zgjidhjet teknike dhe operacionale përkatëse të funksionimit normal të platformës së Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.

Organizimi dhe ndërveprimi ndërinstitucional i aktiviteteve, punës dhe afateve të Operatorit të mjedisit të Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat përcaktohen në rregullore të miratuar nga titullari i këtij institucioni.

Operatorit të mjedisit Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat paraqet në mënyrë periodike pranë Komitetit Mbikëqyrës raporte të monitorimit mbi funksionimin e DVKD-së, raportet e performancës dhe statistikatat përkatëse.

Autoritetet Kompetente Bashkërenduese kanë këto përgjegjësi:

- a) Sigurojnë marrjen e masave për ndërveprueshmërinë e sistemeve të tyre elektronike jodoganore me mjedisin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, për të mundësuar shkëmbimin e automatizuar të të dhënave.
- b) Vendosin në dispozicion të Autoritetit Doganor, përmes Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, të dhënat e nevojshme për verifikimin e automatizuar të dokumenteve mbështetëse, të tilla si leje, licenca, autorizime, apo të ngjashme që ato lëshojnë.
- c) Përdorin të dhënat e marra nga Autoriteti Doganor për menaxhimin e sasisë së mallrave të autorizuara në sistemet e tyre.
- d) Veprojnë si kontrollues të përbashkët të të dhënave personale, së bashku me Autoritetin Doganor, për të dhënat që u përkasin formaliteteve të tyre.
- e) Zbatojnë vendimet, detyrat dhe përgjegjësitë që u ngarkohen nga institucionet dhe organet zbatuese të këtij ligji brenda fushës së përgjegjësisë, sipas përcaktimeve në legjislacionin respektiv.

Operatorët Ekonomikë kanë këto përgjegjësi:

- a. Të dorëzojnë në mënyrë elektronike, përmes pikës së vetme të hyrjes së Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për përmbushjen e formaliteteve doganore dhe jodoganore.
- b. Të sigurojnë saktësinë, plotësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të transmetuara përmes sistemit.
- c. Të respektojnë procedurat, afatet dhe standardet teknike të përcaktuara për përdorimin dhe funksionimin e Mjedisit të Dritares së Vetme Kombëtare.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Aktualisht nuk ka një ligj specifik për krijimin dhe funksionimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, megjithatë kuadri ligjor aktual është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme, përafruar dhe modernizuar në përputhje me Acquis të BE-së, duke ofruar një mjedis ligjor të përshtatshëm për krijimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.

Në veçanti:

- legjislacioni doganor,
- Ligji për Qeverisjen Elektronike,
- Ligji për Shërbimet,
- Ligji për Tregtinë Elektronike,
- Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore, krijojnë një themel të qëndrueshëm për ngritjen e DVKD.

Lidhur me legjislacionin doganor Shqipëria prej vitesh ka qenë në proces të afrimit me Union Customs Code (UCC) të BE-së. Burimet e BE dhe OECD/SIGMA raportojnë se Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në: vlerësimin doganor, garancitë doganore, procedurat e importit dhe eksportit, tranzitit, etj..

Gjithashtu sipas raporteve të Bankës Botërore dhe UNCTAD, Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm në automatizimin e procedurave, konsolidimin e platformave elektronike, përdorimin e sistemeve të avancuara për menaxhimin e tranzitit dhe deklarimeve. Këto element krijojnë themelin e nevojshëm që DVKD të funksionojë si një sistem i integruar, i standardizuar dhe i orientuar drejt BE-së.

Lidhur me ligjin “Për Qeverisjen Elektronike” ky kuadër ligjor është modernizuar ndjeshëm pas vitit 2023, duke përfshirë forcim të rolit të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), rritje të transparencës dhe standardeve të vendimmarrjes, standardizim të

shërbimeve elektronike, si dhe vendosjen e detyrimeve të reja për institucionet publike për integrim të platformave.

Gjithashtu edhe kuadri për tregtinë elektronike është përmirësuar duke rritur sigurinë e transaksioneve online, vendosur standarde për komunikimin elektronik, krijuar detyrime për autenticitet dhe integritet të dokumenteve digjitale.

Këto standarde janë të domosdoshme për funksionimin e një platforme të vetme që mbledh, verifikon dhe shpërndan dokumente doganore dhe jo-doganore.

Gjithashtu në vitin 2024, Shqipëria miratoi ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale, i harmonizuar plotësisht me GDPR. Kjo rrit pikërisht sigurinë ligjore për shkëmbimin e informacionit ndërinstitutional, që është themelor për funksionimin e DVKD.

Lidhur me kuadrin ligjor për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, reformat e administratës publike 2024–2025 kanë sjellë përmirësime të dukshme si rritje efikasiteti të administratës, rritje meritokracie dhe profesionalizimi, modernizim i proceseve me digjitalizim dhe sisteme HRMIS.

Sipas OECD/SIGMA (2025), Shqipëria ka bërë përparim të rëndësishëm në integrimin e shërbimeve online dhe rritjen e efikasitetit të administratës. Kjo garanton që DVKD do të ketë kapacitete për funksionim të qëndrueshëm

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Natyra e problemit:

Rregullatore – Shkaqet lidhen me mungesën e një baze ligjore specifike që përcakton funksionimin, kompetencat, detyrimet dhe mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstitutional për krijimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, si dhe me nevojën për harmonizimin e plotë me Acquis të Bashkimit Europian dhe standardet ndërkombëtare mbi mjedisin e vetëm doganor.

Jo-rregullatore – Lidhen me aspekte operative dhe teknike, si vonesat që vijnë nga sistemet e paunifikuara informatike, kapacitetet e kufizuara për integrim sistemesh dhe nevoja për trajnime të vazhdueshme. Megjithatë, këto sfida operative janë plotësuese dhe të varura nga krijimi i kuadrit ligjor, ndaj thelbi i problemit mbetet qartësisht rregullator, sepse vetëm përmes ndërhyrjes ligjore mund të garantohet standardizimi, detyrueshmëria dhe funksionimi i një sistemi të vetëm të integruar ndërinstitutional.

Rregullatore

Thelbi i propozimit të kësaj nisme lidhet me faktin se legjislacioni aktual nuk ofron një ligj specifik për krijimin dhe funksionimin e një dritare të unifikuar për shkëmbimin elektronik të të dhënave ndërmjet doganave dhe institucioneve të tjera shtetërore. Elementet rregullatore që e bëjnë të domosdoshme ndërmarrjen e kësaj nisme janë si vijon:

- Mungesa e një baze ligjore specifike

Aktualisht nuk ekziston një instrument ligjor që përcakton specifikisht modelin “Dritare e Vetme Kombëtare për Doganat”, që u jep kompetencë institucioneve të bashkëveprojnë dhe të shkëmbejnë të dhëna ndërmjet tyre, duke garantuar uniformitet të procedurave dhe standardeve ndërinstitutionale. Për shkak të mungesës së një ligji specifik flukset e punës dhe procedurat në disa raste mbeten të pakoordinuara, standardet teknike dhe dokumentare ndryshojnë nga një institucion në tjetrin, nuk ekziston një autoritet përgjegjës për menaxhimin qendror të sistemit, çka krijon paqartësi dhe fragmentim.

Jo-rregullatore

Proceset operationale ndërinstitutionale sot janë të fragmentuara dhe jo të standardizuara, pasi çdo institucion ndjek flukse pune, procedura të brendshme dhe kërkesa dokumentare të ndryshme, të cilat nuk janë të harmonizuara me njëra-tjetrën. Kjo sjell verifikime të dyfishta, kërkesa të përsëritura për dokumente, ngarkesë të lartë administrative dhe kohë të zgjatur për trajtimin e kërkesave të operatorëve ekonomikë.

Standardizimi i këtyre proceseve është i domosdoshëm për të siguruar efikasitet dhe transparencë. Megjithatë, ky standardizim nuk mund të arrihet përmes zgjidhjeve të pjesshme administrative, sepse kërkon një bazë të qartë dhe detyruese ligjore që të angazhojë të gjitha institucionet në një regjim të unifikuar operativ.

Shumë institucione të përfshira në proceset doganore dhe në mekanizmat e lehtësimit të tregtisë përballen me kapacitete të kufizuara teknike. Infrastruktura informatike në shumicën e rasteve është e paunifikuar ose e bazuar në sisteme që nuk janë projektuar për të ndërvepruar me platforma të tjera, apo për të përpunuar sasi të mëdha të të dhënave dhe dokumenteve elektronike. Kjo gjendje sjell vonesa në kryerjen e procedurave, rrit kohën e koordinimit ndërmjet institucioneve bashkërenduese dhe shton rrezikun për gabime teknike apo bllokime të proceseve doganore.

Për më tepër, mungesa e standardeve të përbashkëta teknike mes institucioneve nënkupton përdorimin e platformave, databazave dhe formateve të ndryshme dokumentare, çka e bën të vështirë kompatibilitetin e sistemeve dhe kërkon ndërhyrje teknike komplekse – shpesh të kushtueshme për t’i bërë ato të komunikojnë me njëri-tjetrin.

Rritja e shpejtë e tregtisë ndërkombëtare dhe *e-commerce* ka rritur nevojën për bashkëpunim dhe koordinim më të mirë midis autoriteteve të përfshira në procesin e zhdoganimit të mallrave në vend. Procesi i digjitalizimit bën të mundur adresimin më efikas të kësaj situate, duke lidhur sistemet e autoriteteve doganore me të autoriteteve të tjera kompetente bashkërenduese dhe

duke mundësuar shkëmbim të automatizuar të të dhënave mes tyre, me qëllim forcimin e bashkëpunimit në procedurat doganore dhe jo-doganore.

Në këtë kuptim, kuadri aktual rregullator është i pamjaftueshëm për të mbështetur ndërveprimin efektiv midis autoriteteve doganore dhe autoriteteve të tjera kompetente bashkërenduese. Një proces i plotë, i koordinuar dhe efikas i zhdoganimit të mallrave kërkon një mjedis rregullator të thjeshtuar, që mbështet efektivitetin dhe funksionimin e duhur të tregut dhe siguron mbrojtjen e konsumatorit.

Aktualisht, proceset e importit dhe eksportit përballen me disa sfida që e bëjnë të domosdoshme ndërmarrjen e nismës për krijimin e Dritares së Vetme Kombëtare. Procedurat janë të fragmentuara dhe kërkojnë ndërveprim me shumë institucione, duke sjellë dorëzim të përsëritur të dokumentacionit, si dhe në disa raste vonesa për operatorët ekonomikë. Mungesa e një sistemi të unifikuar të shkëmbimit të informacionit shkakton vështirësi në koordinimin ndërinstitutional. Po ashtu, një pjesë e proceseve aktuale mbeten pjesërisht manuale, çka krijon hapësirë për transparencë të kufizuar dhe risk për ndërveprime subjektive. Mekanizmat ekzistues të kontrollit kufitar mbështeten në burime të shpërndara, duke e vështirësuar parandalimin e rreziqeve dhe menaxhimin efikas të flukseve tregtare. Këto sfida pengojnë modernizimin e doganave, ulin konkurrueshmërinë e tregut dhe krijojnë devijime nga praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare, duke e bërë të domosdoshme ngritjen e një platforme të integruar, transparente dhe dixhitale si Dritarja e Vetme Kombëtare.

Problematikat që adreson kjo nisëm kanë një shtrirje të gjerë si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Në nivel kombëtar, këto problematika prekin procedurat doganore që lidhen me importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave, duke ndikuar drejtpërdrejt në veprimtarinë e doganës dhe bashkëveprimin e saj me të gjitha institucionet e tjera kompetente (autoritetet fitosanitare, veterinare, bujqësore, mjedisore, të standardizimit etj.). Mungesa e një sistemi të unifikuar krijon vonesa, ngarkesë administrative dhe procedura të fragmentuara që ndikojnë në mënyrë të përgjithshme efikasitetin e zinxhirit të kontrollit kufitar dhe të shërbimeve publike të lidhura me to.

Në nivel ndërkombëtar, këto problematika shtrihen në sferën e harmonizimit me standardet dhe praktikat e BE-së dhe të organizatave ndërkombëtare që mbikëqyrin lehtësimin e tregtisë dhe procedurat doganore. Mosharmonizimi me aktet ndërkombëtare krijon barriera të brendshme, por njëkohësisht kufizon aftësinë e Shqipërisë për të ndjekur ritmin e modernizimit të sistemeve doganore të vendeve partnere në tregtinë globale. Kjo shtrirje ndërkombëtare e problematikës është indirekte, por thelbësore, pasi përmbushja e standardeve të BE-së dhe të praktikave ndërkombëtare është një element kryesor për integrimin evropian dhe konkurrueshmërinë tregtare të vendit.

Konkretisht problematikat aktuale prekin:

Autoritetet publike: Administratën Doganore dhe Autoritetet e tjera kompetente bashkërenduese:

a) Koordinimi ndërinstitucional

- Aktualisht, operatorët ekonomikë duhet të ndërveprojnë me një numër të madh institucionesh doganat, autoritetet fitosanitare, veterinare, mjedisore, inspektoriatet, agjencitë rregullatore, etj, duke qenë se këto autoritete punojnë në sisteme të ndryshme. Çdo institucion kërkon dokumente, deklarime dhe verifikime të veçanta, shpesh me formate të ndryshme. Kjo krijon proces të ndërlikuar dhe të shpërndarë, ku çdo hap varet nga një institucion i veçantë.
- Gjithashtu në disa raste kjo sjell vonesa në marrëdhëniet ndërinstitucionale.

b) Mundësia për ndikim subjektiv

- Procedurat e shpërndara dhe manuale krijojnë hapësira për pasiguri si dhe për interpretime subjektive. Mospasja e një platforme që gjurmon çdo hap të procesit krijon risk për mosuniformitetin e vendimmarrjeve.

c) Përdorimi i teknologjive moderne

Ndërsa disa procese janë të digjitalizuara, disa prej tyre vijojnë të jenë manuale.

Mungesa e automatizimit është një proces që kërkon më tepër kohë si dhe pengon shkëmbimin automatik dhe në kohë reale të të dhënave. Kjo situatë sjell në disa raste vonesa të proceseve të zhdoganimit, si dhe vështirësi në verifikimin e dokumentacionit.

ç) Përshtatja me standardet ndërkombëtare

Shumë vende të rajonit dhe BE kanë implementuar tashmë modele të avancuara të Dritareve të Vetme, të cilat harmonizojnë procedurat, reduktojnë kohët e zhdoganimit, rrisin efikasitetin institucional.

Nëse nuk kryhet harmonizimi i legjislacionit të brendshëm me standardet ndërkombëtare, kjo do të ndikojë në iniciativën e ndërmarrë për harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian. Zbatimi i standardeve të WCO, WTO-TFA dhe normave europiane kërkon një nivel më të lartë automatizimi dhe koordinimi.

Biznesin: Operatorët ekonomikë në fushën e import/eksport, transportit:

a) Procedura të shpërndara

Pjesa më e madhe e dokumentacionit duhet të dorëzohet disa herë, në forma të ndryshme, tek institucione të ndryshme. Operatorët dërgojnë të njëjtat të dhëna në shumë sisteme ose zyrat fizike. Kjo sjell në disa raste sjell vonesa, si dhe rrit kostot e menaxhimit administrativ.

Gjithashtu proceset e fragmentuara dhe manuale sjellin kosto të larta për bizneset, të cilat duhet të menaxhojnë staf të dedikuar vetëm për procedura dokumentacioni, si dhe rritje të kostove logjistike dhe magazinimit.

Për të arritur një mjedis plotësisht digjital dhe një proces efikas të zhdoganimit të mallrave për të gjitha palët e përfshira, është e nevojshme të vendosen rregulla të reja bashkëpunimi midis këtyre autoriteteve, në një mjedis të unifikuar si ai i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat. Ky mjedis duhet të përfshijë një grup shërbimesh elektronike plotësisht të integruara, për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin digjital ndërmjet autoriteteve doganore dhe autoriteteve kompetente partnere, si dhe për të thjeshtuar proceset e zhdoganimit të mallrave për operatorët ekonomikë. Kjo nismë duhet të çojë, në veçanti, drejt një mbrojtje më të mirë të qytetarëve dhe drejt reduktimit të barrës administrative për operatorët ekonomikë dhe autoritetet doganore.

Për të realizuar këtë nismë, nevojitet një bazë ligjore dhe rregullatore e harmonizuar me legjislacionin e BE në këtë drejtim, marrëveshjet e tregtisë së lirë, si dhe instrumentat udhëzues dhe rekomandimet.

Qytetarët - Vonesat në procedura dhe fragmentimi i kontrolleve doganore ndikojnë drejtpërdrejt në kohën e zhdoganimit të mallrave të importuara. Kjo ka pasoja të menjëhershme për qytetarët, duke ndikuar në çmimet e produkteve, disponueshmërinë në treg dhe cilësinë e mallrave që ata konsumojnë çdo ditë.

Disponueshmëria dhe furnizimi i rregullt me mallra

Vonesat në zhdoganim krijojnë mungesa të përkohshme në treg, sidomos për produkte ushqimore, mjekësore, pajisje elektronike dhe produkte të sezonit. Me Dritaren e Vetme Kombëtare, procedurat përshpejtohen, dokumentet verifikohen në mënyrë të unifikuar dhe mallrat qarkullojnë më shpejt, duke garantuar që qytetarët të kenë furnizim të qëndrueshëm dhe pa ndërprerje.

Ndikim në çmimet e produkteve

Sa më të ngadalta të jenë procedurat doganore, aq më të larta bëhen kostot e biznesit për magazinim, transport, penalitete për vonesa dhe menaxhim të dokumentacionit. Ndërsa një proces i thjeshtuar dhe i digjitalizuar ul kostot operacionale dhe ndihmon në stabilizimin ose uljen e çmimeve të mallrave të konsumit.

Cilësia e produkteve

Kur institucionet nuk operojnë në sistem unik, ekziston rreziku që mallrat të qëndrojnë gjatë në magazine dhe kërkohet më tepër kohë për kontrollin e tyre. Me proces të unifikuar, verifikimet bëhen më të shpejta, më të sakta dhe më të sigurta, duke garantuar që produktet që arrijnë te qytetarët janë në standardet e kërkuara për shëndet dhe siguri

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*

- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë*

Angazhimi politik i qeverisë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian ka një rëndësi të veçantë dhe do të ketë ndikim në përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *Acquis* në çdo sektor, jo vetëm në fushën e transportit dhe procedurave doganore. Përafrimi i plotë me *acquis* të Bashkimit Evropian është një detyrë kryesore për të gjitha institucionet dhe shkon shumë më tej sesa objektivi i këtij projekti, i cili është përgatitja për krijimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat. Kjo do të thotë konkretisht se ndryshimet që do të kërkojnë për ngritjen e një Dritare të Vetme Kombëtare Doganore duhet të jenë me qasje afatgjatë dhe të parashikojnë përafrimin me Bashkimin Evropian dhe respektimin e Marrëveshjes CEFTA.

Qeveria Shqiptare e ka identifikuar krijimin e një Dritare të Vetme Kombëtare për Doganat si një masë kombëtare për lehtësimin e tregtisë, pjesë e Strategjisë Kombëtare për anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe një element për përmbushjen e angazhimeve dhe objektivave rajonale dhe ndërkombëtare, përfshirë Marrëveshjen për Lehtësimin e Tregtisë të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe normat e Bashkimit Evropian.

Nisma është në funksion të përmbushjes së programit politik të Këshillit të Ministrave si dhe Strategjisë Ndërsëktoriale **“Agjenda Digjitale e Shqipërisë” Dhe të Planit Të Veprimit 2022–2026**, në fushën e inovacionit dhe teknologjisë së informacionit, i cili lidhet me shtimin dhe promovimin e shërbimeve digjitale, për qytetarët dhe biznesin. Në këtë dokument përmendet nisma për krijimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat (Single Window) si pjesë e reformës për digjitalizimin e administratës doganore dhe lehtësimin e tregtisë. Ky angazhim është pjesë e objektivave për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve doganore dhe për të përmbushur standardet e Bashkimit Evropian në kuadër të procesit të integrimit.

Projekti “Lehtësimi i Tregtisë dhe Transportit të Ballkanit Perëndimor” është pjesë e fazës së parë të Programit të përbashkët për vendet e Ballkanit Perëndimor, i cili synon të lehtësojë arritjen e qëllimit të qeverive për të ulur kostot tregtare dhe për të rritur efikasitetin e transportit përmes një afati më afatgjatë, angazhimi adaptiv dhe të vazhdueshëm.

- **Faza 1** përfshin Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë.
- **Faza 2** përfshin Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Malin e Zi.

Projekti propozon një qasje të integruar duke përfshirë tre dimensione të lidhura, për të ndihmuar në uljen e kostos së tregtisë dhe rritjen e efikasitetit të transportit në Ballkanin Perëndimor. Këto përfshijnë masa që synojnë:

- Lehtësimin e lëvizjes ndërkufitare të mallrave,
- Rritjen e efikasitetit të transportit;
- Rritjen e aksesit në treg për tregtinë e shërbimeve dhe investimeve.

Projektimi dhe instalimi i një Dritareje të Vetme Kombëtare për Doganën (DVKD) në Republikën e Shqipërisë, është pjesë e Komponentit 1 të këtij projekti.

Administrata publike, veçanërisht ajo doganore, ka kaluar në një fazë të avancuar digjitalizimi, duke ofruar një numër të lartë të shërbimeve tërësisht online.

Konkretisht deri në fund të vitit 2025, dogana ka finalizuar digjitalizimin e një sërë shërbimesh, duke ofruar shërbime online, që mbulojnë të gjithë ciklin doganor: deklarimet, licencat, autorizimet, pagesat dhe proceset e kontrollit. Kjo do të thotë se për çdo veprim doganor nuk kërkohet më prania fizike e qytetarëve apo operatorëve ekonomikë në sportele, duke krijuar bazën teknologjike të përshtatshme për funksionimin e New Single Window me standardet “paperless”.

Digjitalizimi ka sjellë ulje të qartë në kohën e përpunimit të aplikimeve dhe deklaratave dhe ka reduktuar në mënyrë të dukshme burokracinë dhe rritur lehtësinë e aksesit. Nga janari në tetor 2025, është regjistruar rënie e kohës mesatare të përpunimit të procedurave doganore, duke krijuar procese më efikase për përdoruesit.

Gjithashtu shërbimet digjitale duke ulur kontaktin direkt me sportelet, kanë reduktuar mundësitë për abuzim si dhe duke rritur gjurmueshmërinë e çdo veprimi administrativ. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen e korrupsionit dhe rritjen e besimit të publikut.

Digjitalizimi i shërbimeve shërben si fazë përgatitore për arsye se:

- standardizon proceset,
- garanton sigurimin teknologjik,
- krijojnë një bazë të dhënash të harmonizuara,
- mundëson ndërveprueshmëri ndër-institucionale

Përdorimi i shërbimeve online dhe ndërtimi i sistemeve të reja doganore (p.sh., sisteme të riskut, kontrollit, autorizimeve) ka krijuar një ambient të integruar teknik që bën të mundur implementimin e NSW.

Krijimi dhe funksionimi i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat përbën një nga nismat më të rëndësishme në kuadër të reformave që lidhen drejtpërdrejt me procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, veçanërisht në kuadër të kapitullit 29 – Bashkimi Doganor. Strategjia e re e zhvillimit të sistemeve doganore parashikon përafrimin e plotë me modelet evropiane, përmes tre shtyllave kyçe: integrimit me sistemet qendrore trans-evropiane (shkëmbimi i certifikatave, sistemet e kontrollit të importeve dhe menaxhimit të riskut), përafrimit me sistemet decentralizuese trans-evropiane si NCTS dhe centralised clearance, si dhe forcimit të sistemeve kombëtare të përputhshme me kërkesat e BE-së, përfshirë sistemet e njoftimit të mbërritjes, depozitimit të përkohshëm dhe importit.

Nisma e propozuar synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me Rregulloren e BE-së 2022/2399 mbi mjedisin e dritares së vetme doganore, duke standardizuar procedurat, duke mundësuar shkëmbim të unifikuar të të dhënave dhe duke përgatitur vendin për ndërveprueshmëri ndërkufitare sipas praktikave të BE-së. Kjo nismë konsiderohet pjesë e reformave strukturore të nevojshme për modernizimin e procedurave ndërkufitare dhe lehtësimin e tregtisë, duke përputhur Shqipërinë me detyrimet e CEFTA-s dhe Marrëveshjes së Lehtësimit të Tregtisë të OBT-së.

Pra, nisma e propozuar synon të harmonizojë sistemin kombëtar me standardet e Bashkimit Europian për mjedisin e vetëm doganor. Në veçanti me:

- Rregulloren (BE) 2022/2399 për krijimin e Mjedisit të Vetëm Doganor, e cila kërkon integrim të sistemeve kombëtare, shkëmbim elektronik të të dhënave dhe bashkëpunim ndërinstitucional të detyrueshëm. Kjo rregullore parashikon integrimin e sistemeve kombëtare, shkëmbimin elektronik të të dhënave dhe bashkëpunimin e detyrueshëm ndërinstitucional. Shqipëria, si vend në proces integrimi, duhet të përafrohet me këtë model për të siguruar procedura doganore të harmonizuara me ato të BE-së dhe për të mundësuar funksionimin e një pikë të vetme hyrje për operatorët ekonomikë.
- kërkesat e Marrëveshjes së Lehtësimit të Tregtisë (TFA) të Organizatës Botërore të Tregtisë. TFA kërkon thjeshtim, standardizim dhe dixhitalizim të procedurave doganore, duke promovuar krijimin e sistemeve “single window” si instrument kryesor për lehtësimin e tregtisë. Nisma është e nevojshëm për përmbushjen e këtyre detyrimeve ndërkombëtare.

Në mungesë të një baze specifike ligjore, nuk do të mund të kryhet harmonizimi i procedurave doganore me standardet e BE-së dhe në këtë mënyrë nuk do të mund të përmbushen detyrimet e ndërmarra në kuadër të integritetit evropian.

Analiza e legjislacionit ekzistues ka treguar se kuadri ligjor aktual është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme, është përafruar dhe modernizuar në përputhje me Acquis të BE-së, duke ofruar një mjedis ligjor të përshtatshëm për krijimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.

Ligjet si ligji doganor, ligji për qeverisjen elektronike, ligji për shërbimet, sigurojnë një qasje koherente, që plotësohen nga një sërë aktesh nënligjore, të cilat adresojnë procedurat e administratës publike, ofrimin e shërbimeve online, krijimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për çështje që lidhen me qeverisjen elektronike, si dhe ngritjen e platformës e-Albania.

Gjithashtu, janë miratuar dhe përditësuar dispozita ligjore që lidhen me sigurinë e informacionit, mbrojtjen e të dhënave personale, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe me të drejtat e pronësisë intelektuale, të cilat e forcojnë më tej bazën ligjore dhe institucionale për funksionimin e DVK-së.

Megjithatë, konceptet e reja, terminologjia teknike dhe innovative, si dhe një nivel i ri bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni mes autoriteteve doganore dhe Autoriteteve Kompetente Bashkërenduese që sjell krijimi i DVKD, nuk mund të arrihej vetëm përmes përmirësimit dhe amendimit të kuadrit ligjor ekzistues. Për të krijuar një bazë ligjore solide, dhe siguri juridike, si dhe përcaktimin e standartizimit të këtyre risive konsiderohet e nevojshme ndërmarrja e kësaj nisme, për miratim nëpërmjet këtij ligji.

Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë

Për sa i përket kuadrit ligjor dhe rregullator aktual, mund të themi se është përmirësuar, afruar dhe modernizuar në përputhje me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe është i përshtatshëm për të ofruar bazën ligjore për krijimin e Dritares së Vetme Kombëtare (DVKD). Në veçanti:

- legjislacioni doganor,
- ligji për shërbimet,
- ligji për tregtinë elektronike,
- ligji për bazat e të dhënave të shtetit,
- ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore,
- ligji për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara,
- ligji për qeverisjen elektronike etj, ofrojnë një bazë të përshtatshme për ndërtimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat

Kjo kornizë ligjore është e harmonizuar me kërkesat e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e SIGMA/OECD.

Këto ligje plotësohen nga akte nënligjore, të cilat adresojnë procedurat e administratës publike, ofrimin e shërbimeve online, krijimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për aspektet e qeverisjes elektronike, si dhe krijimin e platformës e-Albania, si një Pikë të Vetme Kontakti (Single Point of Contact).

Për më tepër, janë miratuar dhe përditësuar dispozita ligjore për sigurinë e informacionit, mbrojtjen e të dhënave, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe të drejtat e pronësisë intelektuale.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar dhe ka punuar për shtimin dhe promovimin e shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën, si dhe për përmirësimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve publike.

Gjithashtu, revolucioni digjital i shërbimeve dhe administratës publike në Shqipëri i nisur prej vitit 2014, ka bërë të mundur që një numër i lartë i shërbimeve publike të ofrohen *online*, duke u mbështetur nga një kornizë e posaçme ligjore “*Për Qeverisjen Elektronike*” në vend, duke përfshirë më shumë se 1,200 shërbime elektronike për qytetarët dhe biznese.

Arkitektura digjitale e Shqipërisë është ndërtuar në mënyrë të tillë që lejon shkëmbimin automatik të të dhënave mes institucioneve, duke eliminuar kërkesën për dosje fizike ose dokumente të përsëritura. Platforma e-Albania lidhet me mbi 60 sisteme shtetërore, çka mundëson marrjen e të dhënave direkt nga burimi, pa e ngarkuar qytetarin.

Qeveria shqiptare ka realizuar një transformim të thellë digjital në administratën publike, përmes:

- digjitalizimit të gjerë të shërbimeve,
- krijimit të sistemeve të integruara elektronike, dhe
- modernizimit të kuadrit ligjor.

Këto arritje kanë ulur dukshëm burokracinë, kanë rritur transparencën dhe efikasitetin e shërbimeve publike, kanë përmirësuar ndërveprueshmërinë ndërinstitucionale dhe kanë afruar Shqipërinë me standardet bashkëkohore evropiane.

Krijimi i një mjedisi elektronik për Administratën Doganore, është në funksion dhe në përputhje me objektivat e qeverisë shqiptare për transformimin e të gjitha institucioneve qeveritare në njësi 'pa letra' (*paperless*), përmes përfundimit të përdorimit të teknologjisë me qëllim për të rritur produktivitetin, sigurinë, besueshmërinë dhe efikasitetin, në një kohë ku përgjigja e shpejtë dhe efektive është parësore.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe në kohë.*

Objektivat e synuara të nismës së propozuar janë si vijon:

1. **Lehtësimi i procedurave doganore të importit, eksportit dhe tranzitit**, me dokumenta të standartizuara në një pikë të vetme, duke eliminuar paraqitjen e të njëjtave dokumenta disa herë, në institucione të ndryshme.
2. **Reduktimi i hapësirave për korrupsion dhe për aktivitete të paligjshme** duke dixhitalizuar procedurat dhe duke eliminuar ndërhyrjet manuale në proceset doganore dhe ndërinstitucionale.
3. **Sigurimi i një administrimi të koordinuar, koherent dhe të standardizuar** të të gjitha procedurave në pikat e kalimit kufitar, duke përdorur shkëmbimin automatik të të dhënave për të përmirësuar kontrollin dhe vendimmarrjen, si dhe për të shmangur mbivendosjet dhe vonesat.
4. **Sigurimi i një lëvizjeje më të shpejtë të mallrave** përmes integritetit të të gjithë institucioneve në një platformë të vetme, duke reduktuar kohën e pritjes për kontrolle, verifikime dhe marrjen e vendimeve mbi bazën e të dhënave të përbashkëta.
5. **Rritja e transparencës** përmes vendosjes së mekanizma të qartë të gjurmimit, duke siguruar informacion mbi regjistrimin e kërkesës, kohën e regjistrimit dhe statusin e procedurës për të cilat subjektet kanë aplikuar.
6. **Sigurimi i një zhdoganimi më të shpejtë të mallrave** përmes automatizimit të procesit, reduktimit të dokumentacionit dhe eliminimit të veprimeve të panevojshme, duke mundësuar akses në informacion në kohë reale dhe kryerjen e procedurave në mënyrë më të shpejtë dhe të koordinuar.
7. **Përdorim më efikas dhe produktiv të burimeve**, përmes përdorimit të pajisjeve moderne, sistemeve informatike dhe flukseve të standardizuara rrit produktivitetin e administratës dhe ul kostot operative.
8. **Reduktimi i kostove**, për palët e përfshira në këtë proces, përmes përmbushjes elektronikisht të formaliteteve doganore dhe jodoganore, eliminimit të dokumenteve fizikë, reduktimit të kohës së pritjes, dhe shmangies së kërkesave të përsëritura nga institucione të ndryshme.

9. **Integrim 100% i sistemeve të autoriteteve doganore me sistemet e autoriteteve të tjera kompetente bashkërenduese** që lëshojnë dokumente të nevojshme për zhdoganimin.
10. **Sigurimi i një ndërveprimit të plotë, të qëndrueshëm dhe të automatizuar**, duke përfshirë shkëmbimin automatik të të dhënave, verifikimin në kohë reale të autorizimeve, certifikatave dhe licencave, si dhe eliminimin e dorëzimit fizik ose manual të dokumenteve nga operatorët ekonomikë.
11. **Reduktimi i dokumenteve fizike** të kërkuara për formalitetet doganore dhe jo-doganore, përmes shkëmbimit automatik dhe verifikimit elektronik të të dhënave mes sistemeve.
12. **Rritja e cilësisë së shërbimit** përmes ofrimit të mekanizmave të matshëm të vlerësimit, për identifikimin e vonësive, pikave problematike, praktikave të paunifikuara dhe ndërmarrjes së korrigjimeve.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsionet e mëposhtme janë marrë në shqyrtim për krijimin e një Dritareje të Vetme Kombëtare për Doganat në Republikën e Shqipërisë:

Opsioni 0 (status quo): nënkupton vijimin me ligjin aktual. Në legjislacionin aktual nuk ka të parashkuar një ligj për krijimin dhe funksionimin e një Dritare të Vetme Kombëtare për Doganat dhe për pasojë ky opsion nuk mund të aplikohet. Kjo nisëm përbën një domosdoshmëri për plotësimin e kuadrit ligjor në këtë fushë dhe arritjen e objektivave të synuara si më lartë.

Opsioni 0 (status-quo) nuk mund të aplikohet, pasi nisma për krijimin dhe funksionimin e një Dritare të Vetme Kombëtare për Doganat (DVKD), si një prej komponentëve të “*Projektit për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor, me një qasje programore me shumë-faza*”, është një risi, që nuk mund të realizohet pa krijimin e bazës ligjore të nevojshme. Krijimi dhe funksionimi i DVKD duhet të parashikohet në legjislacionin e brendshëm.

Megjithëse kostot afatshkurtra të opsionit 0 janë formalisht të ulëta (0), pasi nuk pritet ndryshim ligjor, ose investim i menjëhershëm. Kostot afatgjata janë të konsiderueshme, sepse moskrijimi i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat sjell humbje të mundësive për modernizim, rritje të kostove për bizneset dhe vonesa të vazhdueshme në procedurat doganore. Në terma afatgjatë, ekonomia dhe tregtia shqiptare mbeten më pak konkurruese, nëse nuk ndërmerret kjo nisëm.

Në mungesë të një kuadri ligjor të ri, çdo institucion vazhdon të funksionojë sipas rregullave dhe sistemeve të brendshme dhe nuk mund të vendosen standarde të përbashkëta për dokumentet dhe formatet e të dhënave, duke krijuar kështu një situatë ku Dritarja e Vetme nuk mund të operojë as teknikisht dhe as funksionalisht. Mungesa e kësaj reforme ligjore ruan

varësinë nga proceset manuale, duke penguar modernizimin e sistemit doganor. Kjo do të sillte jo vetëm mosrealizim të objektivave të projektit rajonal për Lehtësimin e Tregtisë në Ballkanin Perëndimor, por edhe mungesën e harmonizimit me praktikën e Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare për “Single Window”. Për këtë arsye, vijimi me situatën aktuale është joefektiv, jo i qëndrueshëm dhe jo në përputhje me nevojat strategjike për modernizimin e shërbimeve doganore.

Opsioni 1 (jorregullator):- nënkupton marrjen e masave jorregulatore si kryerja e fushatave ndërgjegjëse dhe rritja e kontrolleve. Ky opsion nuk është i përshtatshëm për t’u zbatuar, pasi problematikat e evidentuara nuk mund të trajtohen nëpërmjet këtyre masave, por kërkohet një rregullim ligjor. Për më tepër problematikat aktuale janë të natyrës rregulatore, jo informuese dhe nuk mund të zgjidhen me masa jorregulatore.

Duke qenë se Dritarja e Vetme Kombëtare për Doganat nënkupton ngritjen e një sistemi të unifikuar, ndërveprues dhe të standardizuar ligjërisht, kjo nisëm nuk mund të arrihet me masa jorregulatore të përkohshme, por kërkon një ndërhyrje të qartë në legjislacion. Asnjë fushatë informimi apo rritje e kontrolleve nuk mund të zëvendësojë mungesën e një ligji të posaçëm që përcakton detyrimet e qarta të institucioneve, mënyrën e shkëmbimit të detyrueshëm të të dhënave, si dhe standardet e harmonizuara të dokumenteve dhe procedurave.

Ky opsion në vend që të reduktojë pengesat, do të vijonte të sillte të njëjta problematika si dublimi i proceseve, kërkesave të përsëritura për dokumente, verifikime të shumëfishta dhe vonesa në proceset e zhdoganimit. Ky opsion nuk do të sillte asnjë përmirësim substancial në rritjen e efikasitetit administrativ, procedurat e zhdoganimit apo në lehtësimin e tregtisë, pasi këto përfitime kërkojnë ndryshime të qarta ligjore, të cilat masat jorregulatore nuk i ofrojnë.

Për më tepër, standardet e Bashkimit Evropian për “Single Window”, kërkojnë në mënyrë të qartë që krijimi dhe funksionimi i Dritares së Vetme të mbështetet në një bazë specifike ligjore dhe jo në masa të pjesshme apo vullnetare. Pa një kornizë të detyrueshme ligjore, kjo do të ndikonte në mospërmbylljen e detyrimeve ndërkombëtare dhe integrimin me sistemet e avancuara të BE-së për lehtësimin e tregtisë.

Ky opsion mund të sjellë disa përfitime të pjesshme si vijon:

Kosto të ulëta afatshkurtra - Masat jorregulatore (fushata informuese, udhëzime të brendshme, koordinime operative) kanë kosto minimale ose të ulëta krahasuar me ndërhyrjet ligjore dhe teknike

Përmirësime të kufizuara në praktikën aktuale - Mund të ndihmojë për të qartësuar disa procedura ose për të reduktuar disa vonesa përmes koordinimit manual, por vetëm në një shkallë shumë të kufizuar.

Fleksibilitet organizativ i përkohshëm - Institucionet mund të testojnë pilote të vogla operacionale (workflow të përditësuar, modele dokumentesh) pa barrën e detyrimeve ligjore të menjëhershme. Kjo ofron të dhëna paraprake për dizajnin e ardhshëm ligjor/teknik.

Së fundi, edhe pse ky opsion sjellë disa përfitime të pjesëshme të evidentuara si më lartë, është i paqëndrueshëm dhe me ndikim minimal afatgjatë. Për këtë arsye, Opsioni 1 konsiderohet i pamjaftueshëm, joefektiv dhe i papërshtatshëm për arritjen e objektivave strategjike të reformës në tregtinë ndërkufitare dhe modernizimin e shërbimeve doganore.

Opsioni 2 (rregullator):– nënkupton ndryshimin e ligjit nr. 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”, ose Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, si ligje ku mund të përshtaten këto ndryshime, pasi në legjislacionin aktual nuk ka një ligj specifik për krijimin e një Dritare të Vetme Kombëtare për Doganat.

Në listën e propozimeve të bëra në raportin përfundimtar “*Blueprint*” të Bankës Botërore, mbi kuadrin ligjor dhe rregullator në Republikën e Shqipërisë, për Krijimin e DVKD, në rekomandimin **TC1-1**, rekomandohet që Shqipëria të ketë një bazë ligjore formale, të detajuar, për krijimin dhe funksionimin e DVKD.

Nëse do të propozohet që kjo nisëm të arrihet përmes një ndryshimi në ligjin nr. 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”, ku përkatësisht në nenin 10, të shtohet një pikë e re (4) që shprehet për krijimin e DVK. Funksionimi i DVK më pas do të bëhet përmes një VKM të re.

Ndryshimi i ligjit nr. 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë” nuk është një opsion i përshtatshëm për krijimin e Dritaresh të Vetme Kombëtare për Doganat, sepse ky ligj është hartuar në funksion dhe objekt krejtësisht të ndryshëm nga modeli i DVKD. Ligji për shërbimet synon rregullimin e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe bizneseve në kuptimin e procedurave administrative të përgjithshme, ndërsa DVKD është një mekanizëm, i cili kërkon standarde teknike, procedurale dhe juridike të integruara midis autoriteteve doganore dhe institucioneve të tjera kompetente. Vendosja e një sistemi të specializuar brenda një ligji kaq të gjerë do të krijonte mospërputhje konceptuale dhe konflikt kompetencash, sepse dispozitat e ligjit ekzistues nuk ofrojnë hapësirat e nevojshme për të përshkruar të gjitha komponentët organizativë, teknologjikë dhe rregullatorë që kërkon DVKD.

Një tjetër problem thelbësor është se edhe nëse do të kryhet ndryshimi në Kodin Doganor, e kufizon funksionalisht DVKD, sepse nuk mund të përfshijë të gjitha organet bashkërenduese që marrin pjesë në këtë proces. Këto elemente nuk mund të përfshihen me një shtesë nenesh të një ligji ekzistues, sepse kjo nisëm kërkon një rregullim më specifik dhe të detajuar.

Shtimi i dispozitave të reja në ligjet ekzistuese krijon gjithashtu rrezik të lartë për fragmentim dhe interpretim subjektiv. Pa një ligj të veçantë, i cili i përshkruan qartë kompetencat, rolet, organet menaxhuese, përgjegjësitë dhe mekanizmat e bashkërendimit, institucionet rrezikojnë ta interpretojnë DVKD në mënyrë të ndryshme – çka sjell zbatim të pabarabartë, standarde të ndryshme dokumentare dhe moskoordinim të proceseve. Sipas këtij opsioni, DVKD do të funksiononte vetëm si një platformë teknike e pjesshme, pa u shndërruar në mekanizmin e unifikuar ligjor.

Gjithashtu, një ndryshim në ligj ekzistues nuk përmbush rekomandimet e Bankës Botërore, të cilat kërkojnë qartësisht një bazë ligjore të dedikuar, të detajuar dhe të harmonizuar për DVKD,

në përputhje me rekomandimin TC1-1 të raportit përfundimtar “Blueprint”. Për pasojë, ndryshimi i ligjeve të tjera nuk do të siguronte nivelin e saktësisë dhe detajimit që kërkojnë këto standarde ndërkombëtare.

Edhe pse ky opsion paraqet disa avantazhe si vijon:

- Proces më i shpejtë se krijimi i një ligji të ri - Ndryshimi i një ligji ekzistues mund të kalojë më shpejt në proces konsultimi dhe miratimi sesa hartimi i një ligji të ri.
- Mund të përdoret si zgjidhje tranzitore - Një ndryshim minimal në një ligj ekzistues mund të krijojë një bazë relativisht të shpejtë, mbi të cilën më pas të nxirret një VKM për funksionimin e DVKD.
- Lehtëson harmonizimin e pjesshëm në një fazë të parë - Institucionet do të kenë të paktën një referencë ligjore për DVKD, edhe nëse jo të plotë
- Kosto më të ulët në terma teknikë lidhur me hartimin- Ndryshimet e pjesshme kërkojnë më pak burime njerëzore, më pak kohë dhe konsultime më të fokusuara.

Në përfundim, Opsioni 2 paraqet rrezikun e krijimit të një sistemi të jo të mirëpërcaktuar, të paqartë dhe të kufizuar, i cili nuk ofron bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e plotë të Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat. Për këtë arsye, ky opsion vlerësohet si jo i përshtatshëm dhe jo i mjaftueshëm për të mbështetur rëndësinë e kësaj nisme.

Opsioni 3 (rregullator) i preferuar: – Miratimi i një ligji për krijimin dhe funksionimin një Dritare të Vetme Kombëtare për Doganat, është opsioni më i përshtatshëm për adresimin e problematikave dhe realizimin e objektivave të përmendur si më sipër.

Realizimi i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganën nuk është vetëm një ndryshim teknik, por një reformë gjithëpërfshirëse institucionale dhe ligjore. Kjo nisëm përfshin ndërhyrje në disa nivele:

1. Ligjor dhe rregullator: Nevojiten ndryshime të thella në kuadrin ligjor vendas, për të krijuar bazën e nevojshme për funksionimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat dhe për të garantuar harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian dhe Marrëveshjen CEFTA. Argumentuar në vijim të këtij opsioni.

2. Institucional dhe organizativ: Krijimi i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganën kërkon koordinim të vazhdueshëm midis doganave dhe autoriteteve të tjera kompetente, për të integruar procedurat, për të reduktuar fragmentimin dhe përsëritjen e informacionit, si dhe për të rritur efikasitetin e vendimmarrjes ndërinstitucionale.

Në listën e propozimeve të bëra në raportin përfundimtar “Blueprint” të Bankës Botërore, mbi kuadrin ligjor dhe rregullator në Republikën e Shqipërisë, për Krijimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, në rekomandimin TC1-1, rekomandohet që Shqipëria të ketë një bazë

ligjore formale, të detajuar, për krijimin dhe funksionimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.

Gjithashtu, më 23 Nëntor 2022 hyri në fuqi Rregullorja e BE 2022/2399 për “Krijimin e Mjedisit të Dritares së Vetme të Bashkimit Evropian për Doganat dhe ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 952/2013” *(e cila tashmë është zëvendësuar nga Rregullorja e BE 2024/2514 e datës 3 Korrik 2024)*. Kjo Rregullore, trajton në mënyrë të detajuar kriteret për ngritjen dhe funksionimin e Dritares së Vetme për Doganat në BE, rregullat për shkëmbimin e të dhënave përmes sistemit me një dritare për doganën dhe sistemeve jo-doganore të BE, sjell koncepte të reja në këtë fushë të cilat revolucionojnë terminologjinë e përdorur deri tani, si dhe sjell nevojën për ndryshime në Kodin Doganor të Unionit.

Krijimi i DVKD sjell nevojën për përfshirjen e koncepteve të reja, rregulla dhe elementë të rinj të bashkëpunimit digjital mes autoriteteve kompetente bashkërenduese (AKB), rregulla të ndërveprimit të vetë Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat me sistemin e BE CSW-CERTEX, etj, gjithashtu lind nevoja për përafrimin e Rregullores BE 2022/2399 në legjislacionin e brendshëm. Për këtë arsye, konsiderohet e arsyeshme të ndiqet Opsioni 3, pra që rregullimi i këtyre koncepteve komplekse të bëhet përmes një projektligji të ri për krijimin dhe funksionimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.

Avantazhet e këtij opsioni

Ky opsion siguron një baza të qartë dhe të unifikuar ligjore, e cila është e nevojshme për funksionimin e një mekanizmi kompleks, ndërinstitutional dhe digjital siç është DVKD.

Miratimi i nismës së propozuar me një ligji të veçantë eliminon çdo paqartësi juridike dhe krijon siguri të plotë ligjore si për institucionet publike ashtu edhe për operatorët ekonomikë. Ky opsion ndikon që të gjitha institucionet jenë të detyruara të zbatojnë procedurat, të bashkërendojnë vendimmarrjen, të shkëmbejnë të dhëna në kohë reale dhe të harmonizojnë dokumentet dhe autorizimet e tyre. Kjo shmang interpretimet subjektive, fragmentimin institucional dhe boshllëqet normative që do të shfaqeshin nëse DVKD do të themelohej vetëm me një akt nënligjor.

Për më tepër, ky opsion implementon plotësisht rekomandimin TC1-1 të raportit përfundimtar Blueprint të Bankës Botërore, i cili kërkon shprehimisht që krijimi i një Single Window të mbështetet në një bazë të detajuar dhe specifike ligjore — dhe jo në ndryshime të pjesshme apo dispozita të vendosura në ligje të tjera me objekt të ndryshëm.

Një tjetër avantazh themelor është fakti që ligji i ri mundëson përafrim të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përfshirë rregulloren 2022/2399 dhe aktet e tjera të politikës doganore të BE-së për krijimin e një “mjedisi të vetëm doganor”, si dhe rregullat për shkëmbimin e të dhënave doganore dhe jo-doganore.

Ligji krijon gjithashtu një bazë të përshtatshme për aktet nënligjore, të cilat më pas mund të detajojnë funksionimin praktik të DVKD. Ligji përcakton parimet, rolet, përgjegjësitë dhe mekanizmat e bashkërendimit; ndërkohë që aktet nënligjore mund të adresojnë aspektet

procedurale, teknologjike dhe operacionale në mënyrë të detajuar, të harmonizuar dhe të zbatueshme.

Po ashtu, nisma për miratimin e një ligji të ri parandalon konfliktet institucionale dhe mbivendosjet me ligjet e tjera, si ligji doganor, ligjet për sigurinë ushqimore, mbrojtjen e bimëve, shëndetin e kafshëve, standardet teknike apo tregtinë. Nëse DVKD do të vendosej në mënyrë të fragmentuar brenda ligjeve ekzistuese, kjo do të krijonte mbivendosje juridike dhe pasiguri në zbatimin e kompetencave. Vetëm një instrument ligjor i veçantë mund të garantojë një bazë të qartë normative dhe të qëndrueshme me rregulla të unifikuara dhe të detyrueshme.

Disavantazhet: Proces më i gjatë - Hartimi, konsultimi dhe miratimi i një ligji kërkon kohë të shtuar dhe kalim në disa faza procedurale (konsultim publik, dakordësim ndërinstitucional, diskutim në komisione parlamentare, votim në Kuvend).

Koordinim ndërinstitucional - Përgatitja e ligjit kërkon përfshirjen e shumë aktorëve (ministri linje, institucione të AKB-ve, sektorë IT, juridikë, partnerë ndërkombëtarë). Për këtë arsye ky proces kërkon më tepër kohë dhe koordinim të vazhdueshëm me të gjitha institucionet deri në finalizimin e kësaj nisme.

Ligji në krahasim me një VKM kërkon ekspertizë juridike dhe teknike si dhe analiza të ndikimit dhe konsultime të gjera me palët e përfshira.

Së fundmi, pas një analize të detajuar të legjislacionit në fuqi, boshllëqeve normative, angazhimeve ndërkombëtare dhe kompleksitetit operacional të kësaj reforme, arrihet në përfundimin se miratimi i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat vetëm me një VKM do të ishte i pamjaftueshëm dhe me risk të lartë, ndërsa rruga e vetme që garanton, sigurinë juridike dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemit është miratimi i një ligji të posaçëm të integruar.

Një tjetër opsiion është miratimi i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave, por ky opsiion është i papërshtatshëm.

Avantazhet: Miratim më i shpejtë - VKM ka një proces më të thjeshtë dhe më të shpejtë miratimi sesa miratimi i kësaj nisme me një projektligj që duhet të kalojë në një procedurë më të gjatë.

Fleksibilitet më i lartë për ndryshime - VKM mund të ndryshohet më shpejt në rast se paraqiten vështirësi teknike, apo ka nevojë për rishikime procedurale, ndërsa një ligj për t'u ndryshuar kërkon një procedurë më të gjatë.

Procesi i hartimit dhe miratimit të VKM-së kërkon më pak burime njerëzore, më pak konsultime, si dhe më pak procedura, në krahasim me një projektligj.

Disavantazhet: Mungesë e një baze ligjore të plotë. Në rast se kjo nisëm do të miratohej me një VKM, atëherë duke qenë se kjo reformë prek shumë institucione, VKM do të ishte i pamjaftueshëm për të krijuar një bazë të plotë dhe specifike për funksionimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.

Nuk krijon bazën e detajuar të kërkuar nga standardet ndërkombëtare - *Blueprint* i Bankës Botërore rekomandon shprehimisht krijimin e një baze ligjore formale, të detajuar dhe të veçantë për DVKD. VKM nuk përmbush standardet e përcaktuara nga Rregullorja e BE 2022/2399, si dhe praktikatat e Mjedisit të Dritares së Vetme të BE-së.

Nuk rregullon në mënyrë të mjaftueshme rolet, përgjegjësitë dhe detyrimet ligjore të Autoriteteve të tjera kompetente bashkërenduese. Duke qenë se Dritarja e Vetme Kombëtare për Doganat është një nisëm që prek disa institucione, VKM do të ishte një mjet i pamjaftueshëm për të bërë një rregullim të plotë të kësaj nisme.

Rrezik i lartë për boshllëqe normative – Në rast se kjo nisëm miratohet me VKM mund të lindin boshllëqe të tilla si: konflikt me ligjin doganor, mungesë detyrimi për AKB-të, paqartësi procedurale për operatorët ekonomikë.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*

Nga nisma e propozuar preken:

Në mënyrë të drejtpërdrejtë preken:

- **Autoritetet publike:**

- Autoritetet doganore;
- Autoritetet e tjera Kompetente Bashkërenduese (AKB), institucione qeveritare, ente, agjenci apo institucione publike, të cilat bazuar në legjislacionin në fuqi, lëshojnë një leje, licencë, autorizim, vërtetim apo çdo dokument tjetër mbështës, me qëllim përmbushjen e formaliteteve jodoganore përkatëse në lidhje me transportin, importin, eksportin dhe zbatimin e kërkesave rregullatore të lidhura me tranzitin, në Republikën e Shqipërisë;

- **Operatorët ekonomikë:**

- Importuesit, eksportuesit, transportuesit, prodhuesit etj, (biznese të mëdha, ndërmarrje të mesme e të vogla);

Në mënyrë indirekte preken:

- Konsumatorët dhe qytetarët;
- Ekonomia e vendit në tërësi.

- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*

- *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*

Ndikimet e drejtpërdrejta

Ndikimet te autoritetet doganore

Autoritetet doganore preken drejtpërdrejt nga kjo nismë, përmes integritit të sistemeve elektronike, vendosjes së rregullave për bashkëpunim digjital, shkëmbimin e të dhënave në një mjedis krejtësisht elektronik etj. Reduktimi i barrës administrative, rritja e transparencës dhe sigurisë, rritja e efikasitetit operacional për shkak të integritit të sistemeve dhe automatizimit të kontrollit, janë ndër ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta që pritet të ketë kjo nismë.

a. Rritje e efikasitetit dhe shpejtësisë së procedurave

Nisma e propozuar do të ndikojë që proceset e kontrollit dhe zhdoganimit të thjeshtohen, sepse verifikimet jodoganore bëhen në mënyrë të sinkronizuar me autoritetet e tjera kompetente Bashkërenduese. Në këtë mënyrë koha e përpunimit të deklaratave doganore ulet ndjeshëm, që përmirëson menaxhimin e fluksit të mallrave në pikat kufitare dhe në doganat e brendshme.

b. Përmirësim i kontrollit të riskut

Duke qenë se sipas nismës së propozuar autoritetet doganore marrin informacion të plotë dhe të unifikuar nga autoritetet e tjera kompetente bashkërenduese në kohë reale, kjo rrit saktësinë e analizës së riskut, si dhe rritet siguria kufitare.

c. Reduktim i ngarkesës administrative

Sipas kësaj nisme eliminohen kërkesat e përsëritura të dokumenteve nga palët e interesuara, si dhe minimizohet komunikimi tradicional me dokumente fizike, shkresa dhe kërkesa të manualizuara.

d. Rritje e transparencës dhe gjurmueshmërisë

Duke qenë se sistemi gjeneron gjurmë të plota digjitale për çdo verifikim, autorizim apo vendim administrativ, sipas kësaj nisme forcohet përgjegjshmëria e doganës për respektimin e afateve dhe procedurave.

e. Unifikim i procedurave në përputhje me standardet e BE

Sipas kësaj nisme sigurohet harmonizim i legjislationit shqiptar me praktikat ndërkombëtare. Në këtë mënyrë kjo nismë përgatit doganat për integrim të plotë me sistemet elektronike europiane të kontrollit dhe verifikimit.

Ndikimet te autoritetet kompetente bashkërenduese

a. Thjeshtim dhe standardizim i procesit të lëshimit të dokumenteve

Sipas nismës së propozuar autoritetet e tjera kompetente bashkërenduese nuk veprojnë më në mënyrë të fragmentuar por përmes një sistemi unik kombëtar, kjo ndikon që procedurat të standardizohen: si formatet, afatet, mënyra e shqyrtimit dhe vendimmarrjes.

b. Rritje e efikasitetit administrativ

Nisma e propozuar do të eliminojë nevojën për paraqitjen në sportele fizike, trajtim dokumentesh letër dhe korespondencë të përsëritur, në këtë mënyrë uljen kostot operacionale si dhe e kohës së shqyrtimit të dokumenteve.

c. Rritje e transparencës institucionale

Duke qenë se çdo vendim i Autoriteteve kompetente bashkërenduese (p.sh. dhënia/refuzimi i lejes) arkivohet në sistem dhe është i gjurmueshëm, përdoruesit finalë do të kenë mundësi të shohin në kohë reale statusin e proceseve të tyre.

d. Përmirësim i shkëmbimit të informacionit

Rriten bashkëpunimi ndërinstitutional ku autoritetet kompetente bashkërenduese marrin të dhëna të sakta nga doganat dhe nga institucionet e tjera pa nevojë për kërkesa të përsëritura. Në këtë mënyrë jo vetëm reduktohet koha e këtyre procesve, por edhe përmirësohet cilësia e verifikimeve rregullatore (shëndet, mjedis, bujqësi, standardizim, siguri teknike etj.).

e. Rritje e përgjegjshmërisë dhe monitorimit të performancës

Përmirësohet procesi që lidhet me aktivitetet doganore dhe jodoganore që lidhen me Dritaren e Vetme Kombëtare për Dogant, ku afatet e vendimmarrjes janë të monitorueshme dhe të matshme. Në këtë mënyrë, identifikohen Autoritetet kompetente Bashkërenduese që shkaktojnë vonesa, duke rritur presionin për përmirësim institucional.

f. Integrim me sistemet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare

Autoritetet kompetente Bashkërenduese përshtatin sistemet e brendshme për t'u lidhur me platforma të tjera digjitale qeveritare. Në këtë mënyrë harmonizimi me kërkesat europiane rrit besueshmërinë dhe cilësinë e informacionit.

Ndikimet te operatorët ekonomikë

a. Thjeshtim i proceseve administrative

Operatorët ekonomikë nuk do të jenë të detyruar të paraqiten fizikisht pranë institucioneve të ndryshme, të dorëzojnë dokumente të përsëritura ose të ndjekin procedura të ndryshme për çdo kërkesë. Në këtë mënyrë kjo nisëm do të ndikojë në shmangien e paraqitjes në shumë institucione, si dhe reduktimin e kohës që bizneset shpenzojnë në procedura joadministrative.

Ky thjeshtim ul kostot financiare dhe administrative dhe i lejon biznesit të fokusohet në aktivitetin ekonomik, jo në procedurat burokratike.

2. Ulje e kohës së përpunimit të mallrave dhe rritje e efikasitetit logjistik

Duke qenë se kjo nismë do të ndikojë në përpunimi më të shpejtë të deklaratave doganore, si dhe shmangie e pritjeve të gjata për leje apo certifikata mbështetëse, kjo do të sjellë për operatorët ekonomik ulje të ndjeshme të kohës së zhdoganimit, reduktim të kostove të magazinimit, transportit dhe vonesave, si dhe rritje të shpejtësisë së qarkullimit të mallrave në zinxhirin logjistik.

Në këtë mënyrë operatorët ekonomikë fitojnë një konkurrueshmëri më të lartë në tregun vendas dhe ndërkombëtar.

3. Rritje e transparencës

Kjo nismë siguron për operatorët ekonomik informim në kohë reale mbi fazën e shqyrtimit, si dhe ulje të kontakteve informale me administratën.

Transparenca rrit sigurinë juridike të bizneseve dhe zvogëlon perceptimin e barrierave administrative.

4. Reduktim i kostove financiare dhe operative

Duke qenë se kjo nismë do të sjellë uljen e kostove të transportit të dokumenteve, shmangien e pagesave për përkthime, legalizime apo përsëritje dokumentesh si dhe reduktim të kostove të magazinimit dhe vonesave, kjo do të ndikojë edhe te operatorët ekonomik të cilët kursejnë kohë, burime njerëzore dhe financiare.

Si rezultat, bizneset mund të planifikojnë më mirë furnizimin, prodhimin, shpërndarjen dhe kontratat e eksport-importit, duke ulur rrezikun e humbjeve financiare dhe të penaltive nga vonesat.

7. Siguri më e lartë në menaxhimin e dokumentacionit

Operatorët ekonomikë përfitojnë një nivel më të lartë sigurie dhe mbrojtjeje të të dhënave të biznesit, duke qenë se sistemi elektronik garanton ruajtje të sigurt të dokumenteve, si dhe gjurmueshmëri të plotë të çdo veprimi.

- *Për ndikimet e indirekte:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e indirekte mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*

Ndikimet indirekte

Ndikimet për konsumatorët dhe qytetarët

1. Rritja e cilësisë së procesit

Kjo nismë do të ndikojë që produktet që hyjnë në tregun shqiptar të kontrollohen më shpejt dhe më në mënyrë më të plotë, dhe për pasojë të shmangen hyrjet e produkteve të pasigurta, ose jo të certifikuara, si dhe forcohet mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së konsumatorit. Në këtë mënyrë konsumatorët përfitojnë një treg më të sigurt dhe më të mbikëqyrur.

2. Përmirësim i transparencës

Nisma e propozuar ndikon që qytetarët të kenë akses të drejtpërdrejtë në informacion mbi kërkesat, tarifatat dhe rregullat, si dhe të reduktohet pasiguria lidhur me proceset doganore dhe jodoganore.

Transparenca e rritur krijon një marrëdhënie më të qartë midis shtetit dhe qytetarit.

3. Rritje e sigurisë juridike për qytetarët

Qytetarët që kryejnë blerje online nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, apo bëjnë dërgesa postare ndërkombëtare, do të përfitojnë procedura më të shpejta dhe më transparente, si dhe më pak vonesa për çështjet doganore.

Kjo e bën procesin e blerjes nga jashtë më të lehtë, më të kuptueshëm dhe më të parashikueshëm.

6. Ulje e rrezikut për ndikime në vendimarrje

Nëpërmjet kësaj nisme reduktohen kontaktet fizike mes qytetarëve dhe zyrtarëve, proceset monitorohen elektronikisht, si dhe çdo veprim është i gjurmueshëm. Kjo ul mundësinë për ndikime të jashtme mbi vendimmarrjen, apo për korrupsion.

Përmirësim i cilësisë së jetës

Duke qenë se kjo nismë do të ndikojë në shërbime më të qarta dhe të aksesueshme dhe në një administratë moderne dhe funksionale.

Për qytetarët, kjo sjell një përmirësim të drejtpërdrejtë në përvojën e ndërveprimit me administratën.

Ndikimet në ekonominë në tërësi,

Rritje e volumit të tregtisë ndërkombëtare

Duke qenë se thjeshtohen procedurat e importit, eksportit dhe tranzitit, në këtë mënyrë rritet qarkullimi i mallrave dhe ulen koha e zhdoganimit. Kjo ndikon në zgjerim të aktivitetit ekonomik, si dhe rritjen e eksporteve dhe konsumit.

Formalizim më i madh i ekonomisë

Sipas kësaj nisme rritet gjurmueshmëria e proceseve, si dhe minimizohen veprimtaritë informale. Në këtë mënyrë këto procedurat më të thjeshta ndikojnë në nxitjen e eksporteve.

Gjithashtu procedurat më të shpejta dhe më efikase nxisin inovacionin, zgjerimin e prodhimit, si dhe investime të mëtejshme në teknologji.

Rritja e investimeve të huaja

Kjo nismë do të ketë ndikim në rritjen e atraktiviteti të vendit për investime, duke qenë se do të sjellë stabilitet rregullator, procedura më të thjeshta, kosto të ulëta operacionale, si dhe transparencë. Element këto që kërkohen më së shumeti nga investitorët e huaj.

Për më tepër kjo nismë ndikon në reduktimin e rrezikut të korrupsionit, si dhe siguron trajtim të barabartë për të gjithë investitorët.

Përmirësim i pozitës së Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare

Duke qenë se kjo nismë synon procese doganore sipas standardeve të Bashkimit Evropian, kjo do të ndikojë në përmirësimin e reputacionit të Shqipërisë si partner tregtar.

Rritje e konkurrencës së ndershme

Kjo nismë do të ndikojë në rritjen e pjesëmarrjes në treg të ndërmarrjeve të vogla, duke ulur barrierat administrative dhe kostot e hyrjes në treg. Nëpërmjet thjeshtimit të procedurave, digjitalizimit dhe eliminimit të ndërveprimeve të panevojshme fizike me administratën, krijohen kushte më të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë, pavarësisht madhësisë apo kapaciteteve të tyre.

Në këtë mënyrë, reduktohen avantazhet e padrejta që mund të kenë subjekte të caktuara për shkak të aksesit më të lehtë në informacion apo ndërveprimeve informale, duke forcuar parimin e trajtimit të barabartë. Gjithashtu, rritja e transparencës dhe gjurmueshmërisë së proceseve administrative kontribuon në uljen e praktikave abuzive dhe të konkurrencës së pandershme.

Si rezultat, krijohet një mjedis më konkurrues dhe më dinamik, ku ndërmarrjet konkurrojnë mbi bazën e cilësisë, efikasitetit dhe inovacionit, duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të tregut dhe përmirësimin e ofertës për konsumatorët.

Ndikimet ekonomike/financiare

Edhe pse nuk janë të matshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në terma monetarë, nisma pritet të sjellë një sërë ndikimesh ekonomike dhe financiare pozitive, si: ulja e kostove administrative dhe operative për autoritetet publike dhe operatorët ekonomikë; reduktimi i kohës së zhdoganimit dhe, rrjedhimisht, i kostove të magazinimit dhe transportit; rritja e efikasitetit logjistik dhe e qarkullimit të mallrave; përmirësimi i klimës së biznesit dhe rritja e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve; nxitja e tregtisë ndërkombëtare dhe e eksporteve; rritja e tërheqjes së investimeve të huaja; si dhe formalizimi më i madh i ekonomisë dhe rritja e të ardhurave potenciale në buxhetin e shtetit në afatgjatë.

Nisma për ngritjen e sistemit “Single Window” për doganat përbën një reformë komplekse, ndërsektoriale dhe me karakter thellësisht transformues, e cila përfshin integrimin e shumë sistemeve ekzistuese, riorganizimin e proceseve administrative dhe bashkërendimin e një numri të madh institucioneve publike dhe aktorësh privatë. Për shkak të kësaj natyre të gjerë dhe dinamike, monetizimi i kostove dhe matja e përfitimeve në terma financiarë paraqesin kufizime të konsiderueshme metodologjike dhe praktike.

Së pari, në lidhje me kostot, ngritja e një sistemi të tillë nuk përbën një investim të vetëm të qartë dhe të izoluar, por një proces progresiv që përfshin komponentë të shumtë si: zhvillimi dhe integrimi i platformave teknologjike, përshtatja e sistemeve ekzistuese të autoriteteve të ndryshme, trajnimi i burimeve njerëzore, ndryshimet në procedura dhe procese, si dhe mirëmbajtja dhe përditësimi i vazhdueshëm i sistemit. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre kostove shpërndahet ndër vite dhe ndër institucione të ndryshme, shpesh duke u mbuluar përmes projekteve të ndryshme, asistencës teknike apo financimeve të donatorëve ndërkombëtarë. Për rrjedhojë, është e vështirë të izolohet dhe të përlogaritet një kosto totale e saktë dhe e drejtpërdrejtë që lidhet vetëm me këtë nismë.

Gjithashtu, një pjesë e kostove janë të natyrës jo-financiare ose indirekte, si p.sh. kostot e tranzicionit institucional, përshtatja e proceseve të brendshme, apo koha e investuar nga administrata dhe biznesi për të adoptuar sistemin e ri. Këto elemente janë të vështira për t’u përkthyer në vlera monetare të matshme dhe të krahasueshme.

Së dyti, në lidhje me përfitimet, shumica e tyre janë të natyrës cilësore, afatgjata dhe shpesh të shpërndara në të gjithë ekonominë. Përfitime si rritja e transparencës, përmirësimi i sigurisë juridike, ulja e mundësive për korrupsion, rritja e besimit të bizneseve dhe qytetarëve, apo përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike nuk mund të maten drejtpërdrejt në terma financiarë. Edhe pse këto efekte kanë ndikim të rëndësishëm ekonomik dhe social, ato manifestohen në mënyrë indirekte dhe progresive, duke e bërë të vështirë atribimin e tyre ekskluzivisht kësaj nisme.

Për më tepër, përfitimet ekonomike si rritja e volumit të tregtisë, rritja e investimeve të huaja apo përmirësimi i konkurrueshmërisë së bizneseve ndikohen nga një sërë faktorësh të jashtëm (si kushtet e tregut ndërkombëtar, politikat fiskale, stabiliteti ekonomik etj.), çka e bën të pamundur izolimin e efektit të drejtpërdrejtë të sistemit “Single Window” në mënyrë të saktë dhe të matshme.

Një tjetër element i rëndësishëm është fakti që kjo nismë është e lidhur ngushtë me procesin e përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian dhe integrimin në sistemet ndërkombëtare. Përfitimet që rrjedhin nga ky harmonizim, si rritja e besueshmërisë së vendit dhe lehtësimi i tregtisë ndërkombëtare, janë kryesisht strategjike dhe afatgjata, duke mos u reflektuar menjëherë në tregues financiarë të matshëm.

Kjo nismë National Single Window (NSW) për tregtinë ndërkufitare në Republikën e Shqipërisë, bazohet në marrëveshjen e kredisë ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për “Projektin e Lehtësimit të Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor, me një qasje programore me shumë-faza” për zbatimin e parashikimit të Komponentit 1 (një)

“Lehtësimi i Lëvizjes së Mallrave ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, me aktivitet kryesor krijimin dhe venien në funksionim të Dritares së Vetme Kombëtare për Doganën.

Marrëveshja e Huasë është ratifikuar me Ligjin nr. 62/2019, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor, me qasje programatike me shumë faza”, dhe ka hyrë në fuqi më 17 janar 2020, në përputhje me njoftimin zyrtar të Bankës (“Notification of Loan Effectiveness”).

Me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 775, datë 19.12.2025, është miratuar shtyrja e afatit të zbatimit të Projektit deri më 15 qershor 2027.

Përlllogaritja e impaktit që do të ketë projektligji në total, përfshirë edhe impaktin për grupet e interesit si bizneset apo dhe konsumatorët final rezulton e vështirë për t’u kuantifikuar në aspektin monetar. Ndikime do të ketë edhe pas mbarimit të afatit të zbatimit të projektit, lidhur me institucionin përgjegjës që i kalon pronësia e sistemit, vijimin e mëtejshëm të ecurisë, si dhe mirëmbajtjen e sistemit. Bazuar në nismën e propozuar AKSHI, do të ketë mundësi të lidh edhe marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për të mirëmbajtur këtë sistem. Si rezultat efekti i ndikimit të këtij projektligji në aspektin monetar do të rezultonte i përlllogaritur i pjesshëm, për të vlerësuar në total të gjitha kostot operationale.

Efekte do të ketë edhe lidhur me faktin se institucionet përgjegjëse që janë pjesë e kësaj nisme do të duhet të përshtasin aktet e tyre të brendshme, me qëllimin kryerjen e proceseve që preken nga kjo nisëm sipas këtij sistemi. Në nismën e propozuar parashikohet ngritja e Komitetit Mbikqyrës për Mjedisin e DVKD-së si organ kolegjal bashkërendues i cili krijohet me urdhër të ministrit përgjegjës për financat dhe përbëhet nga:

- a) 3 përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për financat,
- b) 1 përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për tregtinë,
- c) Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe 3 përfaqësues të tjerë;
- d) Titullari i institucionit përgjegjës për infrastrukturën e shërbimeve të qeverisjes elektronike dhe ofrimin e shërbimeve elektronike TIK;
- e) Titullarët e Autoriteteve Kompetente Bashkërenduese;
- f) 3 përfaqësues të shoqatave të biznesit ose ekspertë të fushës, aktiviteti i të cilëve lidhet me tregtinë ndërkombëtare.

Duke qenë se përfshihen në këtë Komitet edhe titullarët e autoriteteve kompetente, ku aktualisht ky projektligj është në fazën e bashkërendimit, me qëllim shmangien e llogaritjeve financiare të pjesëshme, referojmë se do të kryhet pagesa e tyre referuar VKM “Për shpërblimin e anëtarëve të Këshillave, të bordeve ose të komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”. Në përfundim, për shkak të natyrës komplekse, ndërinstitutionale dhe afatgjatë të kësaj nisme, si dhe për shkak të dominimit të përfitimeve cilësore dhe indirekte, nuk është metodologjikisht e qëndrueshme të realizohet një monetizim i plotë dhe i saktë i kostove apo një matje financiare e drejtpërdrejtë e përfitimeve. Për këtë arsye, vlerësimi i ndikimit të kësaj nisme mbështetet kryesisht në analizë cilësore dhe në tregues indirektë të performancës, të cilët pasqyrojnë më mirë efektet reale të saj në administratë, biznes dhe ekonomi në tërësi.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i preferuar është Opsioni 3, pra miratimi i një ligji të ri i cili do të ofrojë rregullimin e duhur për *“Për Krijimin dhe Funksionimin e DVKD” në Republikën e Shqipërisë.*

Arsyet e përzgjedhjes së këtij opsioni, si opsioni i preferuar janë si më poshtë vijon:

- **Siguron bazën e nevojshme juridike për funksionimin** e kësaj dritare. Për më tepër kjo nismë është një iniciativë që lidhet me harmonizimin e *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian për EU Customs Single Ëindoë Environment dhe ky harmonizim kërkon ndërveprim të detyrueshëm mes sistemeve, unifikim të procedurave, përgjegjësi të qarta institucionale, si dhe mekanizma monitorimi - që vetëm ligji mund t'i garantojë. Kjo e bën Shqipërinë kompatible me BE-në dhe rrit aftësinë për integrim të plotë në sistemet doganore europiane.
- **Adreson drejtpërdrejtë problematikat.** Duke qenë se aktualisht procedurat jodoganore shpërndahen në një numër të lartë institucioneve, si dhe sisteme të ndryshme, kjo shkakton në disa raste vonesa, kosto të larta, si dhe duplikim dokumentesh. Në këtë mënyrë nisma e propozuar nëpërmjet miratimit me një ligj krijon një kornizë të vetme dhe të detyrueshme për standardizim, integrim të plotë teknologjik, shkëmbim të automatizuar të informacionit, si dhe përgjegjësi të qarta dhe të matshme për çdo institucion. Ky është opsioni i vetëm që zgjidh problemin në mënyrë strukturore, jo pjesore.
- **Garantimi i qëndrueshmërisë institucionale dhe teknike.** Nëse nuk do të ndërmerret iniciativa për miratimin e një ligji, atëherë ky sistem do të përballej me disa sfida si do të varej nga vullneti i institucioneve, rrezikohej fragmentimi i ardhshëm, do mungonte detyrimi për mirëmbajtje, si dhe do të mungonin mekanizma për monitorim. Iniciativa për miratimin e kësaj nisme nëpërmjet një ligji i detyron institucionet të bashkëveprojnë me sistemin, krijon një organ të përhershëm koordinues, si dhe vendos mekanizma monitorimi. Pra, garanton funksionim afatgjatë dhe të qëndrueshëm.
- **Redukton ndjeshëm kostot ekonomike dhe kohën e procedurave.** Nëse nuk do të ndërmerret iniciativa për miratimin e një ligji, bizneset dhe qytetarët do të përballen me procedura të fragmentuara, kosto të larta logjistike, si dhe në disa raste me vonesa në zhdoganime. Nisma e propozuar krijon proces të unifikuar elektronik, eliminimin e kontakteve fizike dhe dokumenteve në letër. Kjo ndikon në uljen ndjeshëm të kohës së zhdoganimit, uljen e kostove të magazinimit, transportit dhe operimit, rrit qarkullimin e mallrave, si dhe rrit konkurrueshmërinë e ekonomisë.
- **Përmirëson ndjeshëm transparencën.** Sistemi elektronik i propozuar me një bazë ligjore të mirëpërcaktuar siguron gjurmueshmëri të plotë të çdo veprimi, vendime të dokumentuara

elektronikisht, minimizim të kontakteve fizike, si dhe reduktim të diskrecionit administrativ.

- **Krijon kushte më të mira për investime të huaja.** Duke qenë se investorët e huaj kërkojnë procedura të thjeshta, siguri juridike, dhe transparencë. Nisma e popozuar rrit besueshmërinë e administratës, ulët burokracia, zvogëlon kostot, thjeshton tregtinë ndërkombëtare, si dhe rrit shpejtësinë e operimeve logjistike. Kështu, nisma e propozuar rrit aftësinë e Shqipërisë për të tërhequr investime të huaja konkurruese.
- **Nisma ligjore krijon bazën** që të gjitha të dhënat doganore dhe jodoganore të jenë të integruara, të krahasueshme dhe të standardizuara. Kjo mundëson identifikim të sektorëve me problematika, si dhe planifikim strategjik mbi baza të dhënash reale.
- **Nisma e propozuar sjell lehtësimin e procedurave doganore** të importit, eksportit dhe tranzitit, me dokumenta të standartizuara në një pikë të vetme. Krijimi i një Dritareje të Vetme Kombëtare për Doganat redukton kohën dhe kostot e procedurave të tregtisë.
- **Integrimi i procedurave doganore në një platformë të unifikuar** mundëson kalime më të shpejta kufitare dhe transport më efikas, që ndihmon bizneset shqiptare të furnizohen dhe të eksportojnë më shpejt. Kjo nxit zhvillimin e logjistikës kombëtare, rrit vëllimin e tregtisë rajonale dhe krijon një klimë më të favorshme për investime.
- **Koordinim ndërinstytucional** – Integrimi i të gjitha agjencive/institucioneve shtetërore në një platformë të vetme (dogana, autoritete fitosanitare, veterinare, shëndetësore, etj.) sipas kësaj nisme përmirëson bashkëpunimin dhe redukton mbivendosjet e kompetencave

Për të argumentuar përzgjedhjen e opsionit të preferuar në këtë RIA, kemi përzgjedhur si metodë vlerësimi, metodën e analizës me shumë kritere pasi përlllogaritja e vlerës aktuale neto rezulton e vështirë.

Për të bërë një arsyetim sa më të mirë të opsionit të përzgjedhur është kryer analiza me shumë kritere:

Si fillim janë përcaktuar kriteret dhe pesha përkatëse për secilin kriter:

Efikasiteti në reduktimin e kohës procedurale për kryerjen e zhdoganimeve dhe kostove ekonomike- 4;

Efikasiteti i dixhitalizimit të procedurave doganore nëpërmjet proceseve të unifikuara – 4;

Krijimi i një mjedisi ekonomik më favorizues dhe më pak burokratik për tregtinë ndërkombëtare – 3;

Qartësia juridike dhe kuptueshmëria e legjislacionit – 3;

Kosto-Efektiviteti – 5.

Sipas metodës së vlerësimit me shumë kritere, vlerësimi i opsioneve paraqitet si më poshtë:

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Efikasiteti në reduktimin e kohës procedurale për kryerjen e zhdoganimeve dhe kostove ekonomike.	4	0 (0)	1 (4)	4 (16)	4 (16)
Efikasiteti i dixhitalizimit të procedurave doganore nëpërmjet proceseve të unifikuara	4	1 (4)	2 (8)	3 (12)	4 (16)
Mjedis ekonomik me favorizues dhe më pak burokratik për tregtinë ndërkombëtare	3	0 (0)	1 (4)	2 (6)	3 (9)
Qartesia juridike dhe kuptueshmeria e legjislacionit	3	1 (3)	1 (3)	1 (3)	3 (9)
Kosto-Efektiviteti	5	1 (5)	2 (10)	3 (15)	5 (25)
Pikët		12	29	52	75

Sikurse rezulton nga analiza opsioni i preferuar rezulton opsioni 3 i cila ka dhe numrin më të lartë të pikëve me 75 krahasuar me opsionet e tjera

Si rezultat, vlerësojmë që opsioni më i përshtatshëm dhe nga pikëpamja financiare do të jetë opsioni i hartimi të një ligji për krijimin dhe funksionimin e dritares së vetme kombëtare për doganat në Republikën e Shqipërisë .

Çështje të zbatimit

- o *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- o *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- o *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Institucionet dhe organet që kanë përgjegjësi dhe detyra lidhur me Dritaren e Vetme Kombëtare për Doganat janë:

- a) Ministri përgjegjës për financat;
- b) Komiteti Mbikëqyrës i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat;
- c) Koordinatori Kombëtar;
- d) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- e) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- f) Autoritetet Kompetente Bashkërenduese;
- g) Operatorët Ekonomikë.

Ministri përgjegjës për financat me propozim të Komitetit Mbikëqyrës së Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, miraton me udhëzim, si vijon:

- a) elementet e të dhënave të përbashkëta dhe të dhënat shitesë që shkëmbehen përmes Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat;
- b) rregullat e veçanta të shkëmbimit të informacionit për formalitetet jodoganore;
- c) masat për standardet e garantimit të mbrojtjes së të dhënave personale në këtë proces;
- d) procedura dhe rregulla për zbatimin e këtij neni.

Komiteti Mbikëqyrës për Dritaren e Vetme Kombëtare për Doganat është organ kolegjal bashkërendues i cili krijohet me urdhër të ministrit përgjegjës për financat dhe përbëhet:

- a) 3 përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për financat,
- b) 1 përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për tregtinë,
- c) Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe 3 përfaqësues të tjerë;
- d) Titullari i institucionit përgjegjës për infrastrukturën e shërbimeve të qeverisjes elektronike dhe ofrimin e shërbimeve elektronike TIK;
- e) Titullarët e Autoriteteve Kompetente Bashkërenduese;
- f) 3 përfaqësues të shoqatave të biznesit, aktiviteti i të cilëve lidhet me tregtinë ndërkombëtare.

Komiteti Mbikëqyrës për Dritaren e Vetme Kombëtare për Doganat kryesohet nga Koordinatori Kombëtar.

Komiteti Mbikëqyrës i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të proceseve administrative dhe teknike të Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, çështjeve për lehtësimin e tregtisë të lidhura me rregullat dhe procedurat doganore dhe zbatimit të formaliteteve jodoganore sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj.

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Komitetit Mbikëqyrës miratohet nga ministri përgjegjës për financat me propozimin e Komitetit Mbikëqyrës.

Komiteti Mbikëqyrës shqyrton dhe trajton të gjitha çështjet që lidhen me funksionimin dhe mbarëvajtjen e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.

Komiteti Mbikëqyrës propozon ndryshimet në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse pranë ministrive të linjës, për formalitetet jodoganore që integrohen në mjedisin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, me qëllim përshtatjen e këtij legjislacioni me Kodin Doganor dhe standardet ndërkombëtare. Ai gjithashtu propozon rregullat për popullimin e të dhënave, për lidhjen e sistemeve jodoganore në mjedisin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat dhe për përmbushjen e formaliteteve jodoganore përkatëse, si dhe për administrimin dhe përdorimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat nga Autoritetet Kompetente Bashkërenduese.

Komiteti Mbikëqyrës ndërmjetëson zgjidhjen e mosmarrëveshjeve teknike ose/dhe administrative midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Agjencisë Kombëtare të Shqipërisë së Informacionit dhe autoriteteve kompetente bashkërenduese.

Komiteti Mbikëqyrës, vlerëson dhe vendos për periudhën e aplikimit të tarifave të përdorimit të sistemit elektronik me një Dritare të Vetme Kombëtare për Doganat për shkëmbimin e dokumenteve mbështetëse dhe kategoritë e përdoruesve të këtij sistemi, pasi ky sistem të ngrihet dhe të funksionojë. Këto tarifa shërbimi caktohen duke mbajtur parasysh mbulimin e kostove të nevojshme për mirëmbajtjen e sistemit elektronik, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Komiteti Mbikëqyrës ka të drejtën e përfitimit të shpërblimit për mbledhjet e zhvilluara. Masa e shpërblimit dhe numri maksimal i mbledhjeve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave cakton përbërjen dhe funksionet e sekretariatit teknik të Komitetit Mbikëqyrës.

Koordinatori Kombëtar i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat është nivel i lartë drejtues dhe caktohet me urdhër nga ministri përgjegjës për financat dhe kryen detyrat e mëposhtme:

- a) vepron si pikë kombëtare kontakti për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e dispozitave të këtij ligji;
- b) promovon dhe mbështet në nivel kombëtar, bashkëpunimin ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, autoriteteve kompetente bashkërenduese dhe komunitetit të biznesit për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;
- c) koordinon të gjitha aktivitetet dhe problematikat në lidhje me funksionimin dhe ndërveprimin e mjedisit të DVKD-së në Republikën e Shqipërisë me BE CSĚ-CERTEX.

Koordinatori Kombëtar i paraqet ministrit përgjegjës për financat dhe Këshillit të Ministrave brenda 3 muajve të parë të vitit pasardhës raport mbi zbatimin e këtij ligji, i cili përfshin:

- a) pasqyrën e formaliteteve jodoganore të autoriteteve kompetente bashkërenduese të përfshira në legjislacionin në fuqi dhe propozimet për ndryshimet ligjore përkatëse nëse është e nevojshme;
- b) ecurinë e përdorimit dhe funksionimit të Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat në lidhje me zbatimin e këtij ligji;
- c) një pasqyrë të detajuar të progresit të përgjithshëm të arritur në Dritaren e Vetme Kombëtare për Doganat në lidhje me planin e punës për lidhjen e sistemeve jodoganore me mjedisin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat;
- d) informacione të tjera që lidhen me sfidat dhe komunikimin ndër-institucional;
- e) sipas rastit, indikatorët mbi ndikimin tek operatorët ekonomikë, në veçanti në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe lehtësimin e tregtisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është autoriteti përgjegjës për Dritaren e Vetme Kombëtare për Doganat dhe ka këto përgjegjësi:

- a) Mbikëqyr funksionimin e përgjithshëm të mjedisit të Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat dhe zbatimin korrekt të procedurave doganore për dokumentacionin që administrohet nëpërmjet DVKD.
- b) Përdor mjedisin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat për verifikimin e automatizuar të formaliteteve doganore dhe jodoganore, bazuar në shkëmbimin e të dhënave me autoritetet kompetente bashkërenduese.
- c) Përdor të dhënat e marra, nga autoritetet bashkërenduese, përmes sistemit, për menaxhimin e sasisë së mallrave të autorizuar nga ana e tyre.
- d) Koordinon kontrollet me autoritetet e tjera, kur është e nevojshme, duke përdorur këtë mjedis si një mjet për shkëmbimin e informacionit.
- e) Vepron si kontrollues i përbashkët i të dhënave personale, së bashku me autoritetet kompetente bashkërenduese, për të dhënat e përpunuara në DVKD.

Institucioni përgjegjës për infrastrukturën e shërbimeve të qeverisjes elektronike dhe ofrimin e shërbimeve elektronike TIK në Republikën e Shqipërisë, është Operatori i mjedisit Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat dhe ka këto përgjegjësi:

- a) Krijon, zhvillon, integron dhe siguron funksionimin e pandërprerë teknik të platformës së Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.
- b) Garanton sigurinë kibernetike, integritetin dhe disponueshmërinë e sistemit dhe të dhënave që përpunohen në të, në përputhje me standardet më të larta teknike.
- c) Siguron ndërveprueshmërinë teknike midis sistemeve elektronike të Autoritetit Doganor dhe atyre të autoriteve kompetente bashkërenduese.
- d) Mirëmban dhe përditëson sistemin në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe kërkesat e reja ligjore.
- e) Raporton dhe mban të informuar të gjitha autoritetet përgjegjëse lidhur me problematikat e shfaqura në kohë reale dhe zgjidhjet teknike dhe operacionale përkatëse të funksionimit normal të platformës së Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.

Organizimi dhe ndërveprimi ndërinstitutional i aktiviteteve, punës dhe afateve të Operatorit të mjedisit të Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat përcaktohen në rregullore të miratuara nga titullari i këtij institucioni.

Operatorit të mjedisit Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat paraqet në mënyrë periodike pranë Komitetit Mbikëqyrës raporte të monitorimit mbi funksionimin e DVKD-së, raportet e performancës dhe statistikën përkatëse.

Autoritetet Kompetente Bashkërenduese kanë këto përgjegjësi:

- a) Sigurojnë marrjen e masave për ndërveprueshmërinë e sistemeve të tyre elektronike jodoganore me mjedisin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, për të mundësuar shkëmbimin e automatizuar të të dhënave.

- b) Vendosin në dispozicion të Autoritetit Doganor, përmes Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, të dhënat e nevojshme për verifikimin e automatizuar të dokumenteve mbështetëse, të tilla si leje, licenca, autorizime, apo të ngjashme që ato lëshojnë.
- c) Përdorin të dhënat e marra nga Autoriteti Doganor për menaxhimin e sasisë së mallrave të autorizuar në sistemet e tyre.
- d) Veprojnë si kontrollues të përbashkët të të dhënave personale, së bashku me Autoritetin Doganor, për të dhënat që u përkasin formaliteteve të tyre.
- e) Zbatojnë vendimet, detyrat dhe përgjegjësitë që u ngarkohen nga institucionet dhe organet zbatuese të këtij ligji brenda fushës së përgjegjësisë, sipas përcaktimeve në legjislationin respektiv.

Operatorët Ekonomikë kanë këto përgjegjësi:

- a. Të dorëzojnë në mënyrë elektronike, përmes pikës së vetme të hyrjes së Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për përmbushjen e formaliteteve doganore dhe jodoganore.
- b. Të sigurojnë saktësinë, plotësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të transmetuara përmes sistemit.

Të respektojnë procedurat, afatet dhe standardet teknike të përcaktuara për përdorimin dhe funksionimin e Mjedisit të Dritares së Vetme Kombëtare.

Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.

Kjo nisëm përfshin disa institucione, ndaj pengesat më të mundshme janë:

- **Koordinimi ndërinstitutional:** përfshirja e disa ministrave të linjës dhe institucioneve të tjera kërkon koordinim ndërinstitutional të vazhdueshëm;
- **Aspektet teknike dhe dixhitale:** ndërveprimi mes sistemeve elektronike të ndryshme kërkon standarde të përbashkëta dhe infrastrukturë TIK.
- **Ndryshimet e legjislationit sektorial:** çdo autoritet duhet të përshtasë aktet ligjore/nënligjore, që janë pjesë e fushës së përgjegjësisë së tyre, që mund të ndikojë në këtë proces.
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Për të siguruar funksionimin efektiv të Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat dhe arritjen e objektivave të kësaj nisme, parashikohen këto masa:

- Krijimi dhe funksionimi i Komitetit Mbikëqyrës dhe Koordinatorit Kombëtar, për mbikëqyrjen dhe raportimin e vazhdueshëm të progresit.
- Institucioni përgjegjës për infrastrukturën e shërbimeve të qeverisjes elektronike dhe ofrimin e shërbimeve elektronike TIK në Republikën e Shqipërisë, është Operatori i mjedisit DVKD dhe ka përgjegjësi të krijoj, zhvilloj, integroj dhe siguroj funksionimin e pandërprerë teknik të platformës së Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.

- Autoritetet Kompetente Bashkërenduese kanë përgjegjësi të sigurojnë marrjen e masave për ndërveprueshmërinë e sistemeve të tyre elektronike jodoganore me mjedisin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, për të mundësuar shkëmbimin e automatizuar të të dhënave, si dhe të vendosin në dispozicion të Autoritetit Doganor, përmes Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, të dhënat e nevojshme për verifikimin e automatizuar të dokumenteve mbështetëse, të tilla si leje, licenca, autorizime, apo të ngjashme që ato lëshojnë.
- Autorizohet lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe të ofrimit të shërbimeve, ku Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me Operatorin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, ku të përcaktohet fusha e shërbimit, procedurat dhe standardet e performancës, masat e sigurisë dhe ndërveprueshmërisë, menaxhimin e incidenteve dhe problematikave dhe mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.
- Trajnimi i personelit dhe operatorëve ekonomikë, për përdorimin e platformës dhe zbatimin e procedurave të reja elektronike.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- o *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- o *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Zbatimi i kësaj nisme do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme përmes strukturave të ngritura posaçërisht dhe mekanizmave të raportimit periodik.

- Komiteti Mbikëqyrës i Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat do të mbikëqyrë ecurinë teknike dhe administrative të sistemit, duke analizuar raportet e performancës, nivelin e ndërveprueshmërisë dhe përputhshmërinë me standardet ligjore e teknike.
- Koordinatori Kombëtar do të përgatisë raporte vjetore të vlerësimit për ministrin përgjegjës dhe Këshillin e Ministrave, që do të përfshijnë analizën e progresit, ndikimin tek operatorët ekonomikë dhe rekomandime për përmirësime të mëtejshme.
- Institucioni përgjegjës për infrastrukturën e shërbimeve të qeverisjes elektronike dhe ofrimin e shërbimeve elektronike TIK në Republikën e Shqipërisë, është Operatori i mjedisit DVKD dhe ka përgjegjësi të paraqes në mënyrë periodike pranë Komitetit Mbikëqyrës raporte të monitorimit mbi funksionimin e Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat, raportet e performancës dhe statistikat përkatëse.

Rezultatet e monitorimit do të përdoren për rishikimin periodik të politikave dhe akteve nënligjore, për të siguruar që objektivat e lehtësimit të tregtisë dhe dixhitalizimit të procedurave doganore të realizohen plotësisht.

- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Progresi i zbatimit të kësaj nisme do të matet përmes indikatorëve të performancës që pasqyrojnë efikasitetin dhe ndikimin:

- **Tregues institucionalë:** numri i autoriteteve kompetente që janë integruar në Dritaren e Vetme Kombëtare për Doganat dhe shkalla e bashkëpunimit ndërmjet tyre.
- **Tregues teknikë:** përqindja e formaliteteve jodoganore të digjitalizuara, shkalla e ndërveprueshmërisë së sistemeve dhe numri i transaksioneve të kryera përmes Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat.
- **Tregues kohorë:** ulja e kohës së përpunimit të deklaratave doganore dhe jodoganore krahasuar me periudhën para zbatimit të sistemit.
- **Tregues ekonomikë:** rritja e efikasitetit në lehtësimin e tregtisë, (e cila matet nëpërmjet kohës mesatare të zhdoganimit, para zbatimit të Dritares së Vetme Kombëtare për Doganat dhe pas zbatimit të saj, numrin e dokumenteve dhe procedurave që kërkohen para dhe pas zbatimit të kësaj nisme, volumit të tregtisë) ulja e kostove administrative për bizneset dhe rritja e transparencës e cila matet nëpërmjet gjurmshmërisë së plotë të procedurave, reduktimit të kontakteve fizike me administratë, rritja e aksesit të operatorëve në informacion.
- **Tregues të monitorimit të rregullt:** raportet vjetore të Koordinatorit Kombëtar mbi zbatimin e ligjit, ndikimin në operatorët ekonomikë dhe përputhshmërinë me standardet e BE-së.
- **Tregues të cilësisë së shërbimit:** numri i ankesave ose rasteve të vonësive në përpunimin e dokumenteve, dhe koha mesatare për zgjidhjen e tyre.
- **Tregues të sigurisë dhe transparencës:** përqindja e procedurave që janë plotësisht të gjurmueshme dhe të verifikueshme elektronikisht, numri i incidenteve të humbjes së të dhënave ose gabimeve në sistem.
- **Tregues të ndikimit në treg:** ndryshimi në vëllimin e import/eksportit, rritja e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në treg, ose ulja e devijimeve nga standardet ndërkombëtare.
- **Tregues financiarë të qeverisë:** kursimet e qeverisë për reduktimin e stafit ose kostove administrative, si dhe rritja e të ardhurave nga tarifat doganore për shkak të procedurave më të shpejta dhe më të sigurta.
- **Tregues të përdorimit të sistemit:** numri i përdoruesve aktivë, frekuenca e transaksioneve, dhe niveli i përdorimit të funksioneve të avancuara të sistemit si verifikimi automatik i dokumenteve.
- **Tregues për integrimin me standardet ndërkombëtare:** niveli i përputhshmërisë me WCO, WTO-TFA, dhe standardet e BE-së për doganat dhe kontrollin e mallrave.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca1/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – njëherë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										

Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim (ndryshimi I primit)										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			

**MINISTRI I EKONOMISË
DHE INOVACIONIT**

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTRI I FINANCËVE

PETRIT MALAJ

